

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 5970
E mërkurë, 8 janar 2020
çmimi 0.40 €

Ushtria e Kosovës,
objektiva të qarta
për vitin 2020 FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", ARTAN MURATI FAQE 4-5

TË SHTERËN TË GJITHA MUNDËSITË KUSHTETUESE PARA SE TË MENDOHET PËR ZGJEDHJE



Analisti politik Artan Murati ka deklaruar se është e papranueshme të flitet për zgjedhje të reja vetëm pse LV-ja dhe LDK-ja nuk arrijnë t'i tejkalojnë dallimet e vogla për pozita të caktuara. Në këtë intervistë dhënë

për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Kushtetuta e Kosovës e njeh edhe mundësinë e mandatimit të një kandidati tjetër për kryeministër nëse dështon mandatarin e parë. Murati ka vlerësuar se duhet të

shterëni të gjitha mundësitë kushtetuese dhe reale para se të mendohet për zgjedhje të reja. Sipas tij, LV-ja dhe LDK-ja duhet të jenë realiste në kërkesa për ta arritur një marrëveshje për bashkëqeverisje

AKTUALE



S'KA MARRËVESHJE LV - LDK,
SOT TAKOHEN PËRSËRI KURTI
DHE MUSTAFA F. 5

KËRKESA TË SHUMTA TË
PACIENTËVE PËR TRAJTIM
MJEKËSOR JASHTË KOSOVËS F. 6

KOMUNA E FERIZAJT NGA
QEVERISJA E KALUAR
TRASHËGOI MBI 40 MILIONË
EURO BORXHE F. 10

MYFTIU TËRËNAVA SHKON PËR
VIZITË ZYRTARE NË ARABINË
SAUDITE F. 6

EKONOMI

BQK-ja: ASETET E SISTEMIT
FINANCIAR ARRIJNË VLERËN
7 MILIARDË EURO F. 9

BRENDA NJË VITI RRETH 2 000
RASTE TË TENTIMKONTRA-
BANDIMIT TË MALLRAVE F. 8-9

SPORT

KARAQI: NUK E BRAKTISA
KOSOVËN, POR FEDERATËN E
KARATESË F. 20



Liberalizimi i vizave, premtim që nuk po përmbushet

Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka thënë se Kosova i ka përmbushur kushtet për liberalizim të vizave. Ai ka pohuar se tani kjo është çështje politike e zhvillimeve të brendshme të Evropës dhe nuk lidhet me taksën që Kosova i ka

vendosur Serbisë. Haradinaj ka thënë për "Epokën e re" se nëse Kosova nuk hyn në agjendë në mbledhjen e parë të Këshillit të BE-së, që mbahet në fund të shkurtit apo në fillim marsit të këtij viti, atëherë dihet se kjo po bëhet me

qëllim dhe dihet që është agjendë për ta mbajtur të izoluar. Edhe ish-ministri i Punëve të Jashtme, aktualisht zëvendëskryeministër, Enver Hoxhaj, mendon se liberalizimi i vizave nuk ndërlihet me mospunën e institucioneve të Kosovës FAQE 3

Vlora Çitaku: Jemi të bekuar me relacionin
e veçantë që kemi me ShBA-në FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Shqipëria duhet të dëshmojë se është e aftë t'i respektojë normat e OSBE-së

Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë thotë se Shqipëria ka përgjegjësinë dhe detyrimin përballë OSBE-së, ta justifikojë besimin e dhënë, duke dëshmuar se është vetë e aftë t'i respektojë normat, parimet dhe angazhimet e kësaj organizate në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut si dhe sundimit të ligjit

TIRANË, 7 JANAR - Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë, duke përshëndetur marrjen nga Shqipëria të Kryesisë së radhës të OSBE-së për vitin 2020, nënvizon përgjegjësinë që ka Shqipëria në këtë përfaqësim. Përmes një deklarate për medie, KASH-i thekson se "Shqipëria ka përgjegjësinë dhe detyrimin përballë Organizatës, të justifikojë besimin e dhënë, duke dëshmuar se është vetë e aftë të respektojë normat, parimet dhe angazhimet e OSBE-së në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut si dhe sundimit të ligjit". Sipas Këshillit të Ambasadorëve Shqiptarë, "Vëmendja e pritshme e Kryesisë shqiptare të zhvillimit politik në Ballkanin Perëndimor, është një mundësi për të thelluar më tej bashkëpunimin rajonal, nëpërmjet forcimit të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, pajtimit ndëretnik dhe pjesëmarrjes dhe angazhimit të plotë të Kosovës në të gjitha nismat që ndërmerren për forcimin e paqes dhe stabilitetit në rajon, përfshirë këtu edhe në kuadër të OSBE-së". Një apel KASH e ka edhe për qeverinë, së cilës i kërkon t'i angazhojë burimet më të mira njerëzore të shërbimit diplomatik dhe administratës shqiptare për të menaxhuar me profesionalizëm dhe kompetencë dosjet e shumta që përfshihen

në mandatin e OSBE-së. "Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë përshëndet marrjen nga Shqipëria të Kryesisë së radhës të OSBE-së për vitin 2020. Kryesimi i organizatës më të madhe rajonale të sigurisë përmbush një synim të kahershëm të politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë. Si një sipërmarrje me karakter gjithëpërfshirës, Kryesia duhet t'i shërbejë çuarjes përpara të objektivave strategjike të Shqipërisë, të cilat gëzojnë mbështetjen e të gjithë spektrit politik në vend", thuhet në deklaratën e KASH-it. Thotë se drejtimi i OSBE-së është një arritje madhore e vendit, tregues i besimit të anëtarësisë së OSBE-së në transformimet demokratike të Shqipërisë gjatë tre dhjetëvjeçarëve të fundit, si dhe kontributit të dhënë ndër vite nga diplomacia shqiptare për Organizatën dhe jo vetëm. "OSBE-ja është organizata e parë shumëpalëshe në të cilën Shqipëria aderoi pas rënies së komunizmit dhe hapjes ndaj Perëndimit, që ka mbështetur në mënyrë të vazhdueshme forcimin e demokracisë dhe shtetit ligjor në vendin tonë, si dhe në forcimin e sigurisë dhe stabilitetit në Ballkan. Në këtë kuadër, Shqipëria ka përgjegjësinë dhe detyrimin përballë Organizatës, të justifikojë besimin e dhënë, duke dëshmuar se është vetë e aftë t'i respektojë normat, parimet



dhe angazhimet e OSBE-së në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut si dhe sundimit të ligjit", thuhet në deklaratë. KASH-i vlerëson dhe mbështet prioritetet e paraqitura nga Shqipëria gjatë vitit kaluar, nën moton "t'i zbatojmë angazhimet e OSBE-së së bashku". "Vëmendja e pritshme e kryesisë shqiptare të zhvillimit politik në Ballkanin Perëndimor, është një mundësi për të thelluar më tej bashkëpunimin rajonal, nëpërmjet forcimit të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, pajtimit ndëretnik dhe pjesëmarrjes dhe angazhimit të plotë të Kosovës në të gjitha nismat që ndërmerren për forcimin e paqes dhe stabilitetit në rajon, përfshirë këtu edhe në kuadër të OSBE-së", thuhet në deklaratën e tyre. Këshilli i Ambasadorëve

Shqiptarë falënderon trupën e diplomatëve që ka punuar me përkushtim për përmbushjen e këtij synimi që prej paraqitjes së kandidaturës së Shqipërisë për herë të parë në vitin 2006. "Në vitet 2000, diplomatët shqiptarë drejtuan fillimisht negociatat nën Artikullin IV të Marrëveshjes së Dejtonit, që realizoheshin nën suazën e OSBE-së, dhe, më vonë, drejtuan me profesionalizëm të spikatur Forumin për Bashkëpunim në Siguri (Forum for Security Cooperation), që menaxhon çështjet e një prej dimensioneve më të rëndësishme të Organizatës, dimensionit politiko-ushtarak. Në vitet 2010, për herë të parë, Shqipëria u bë mikpritëse e dy prej aktiviteteve më të rëndësishme të Organizatës, sesionit vjetor të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së dhe Takimit të Nivelit të Lartë të

OSBE-së për të Drejtat e Njeriut, të cilat u organizuan në Tiranë me sukses të plotë. Është edhe në këtë kontekst që Shqipëria merr Kryesinë e radhës së OSBE-së", thuhet më tej në deklaratë. KASH-i fton qeverinë t'i angazhojë burimet më të mira njerëzore të shërbimit diplomatik dhe administratës shqiptare për të menaxhuar me profesionalizëm dhe kompetencë dosjet e shumta që përfshihen në mandatin e OSBE-së. Në fund, Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë i uron stafit të Misionit të Republikës së Shqipërisë në OSBE, grupit të posaçëm të punës, kryeministrit dhe ministrit të Punëve të Jashtme që, në cilësinë e kryetarit të radhës do të drejtojë politikisht Organizatën, punë të mbarë dhe suksese në përballimin e kësaj sfide serioze.

Kryemadhi: 2020-a do të jetë viti i përballjes dhe i fitores

TIRANË, 7 JANAR - Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, paralajmëroi në Konventën e LSI së Tiranës dhe në një intervistë për "Top Channel" se viti 2020 do të jetë vendimtar në përballjen me qeverinë "Rama". Në mesazhet e saj, kryetarja e LSI-së shprehet se opozita nuk duhet të humbasë asnjë orë dhe minutë në përballjen me qeverinë, pasi kjo qeveri ka vënë në lojë interesat kom-

bëtare dhe të ardhmen e vendit. "Viti që sapo kemi hyrë, 2020 do të jetë viti i rezistencës dhe i fitores së padiskutueshme në përballjen tonë me klanin e tradhtarëve të interesave kombëtare, me grupet e hajdutëve të votave, me uzurpatorët dhe shkatërruesit e ekonomisë së vendit, me krimin që ka fytyrën e rilindjes, sepse ne jemi sot shumica absolute e padiskutueshme e shqiptarëve.



Çdo orë dhe minutë është shumë e çmuar, prandaj për asnjë çast nuk mund të flemë të qetë përballë Shqipërisë që lëngon. Çdo sakrificë e jona nuk është asgjë për të shpëtuar Shqipërinë nga sëmundja e rilindjes", - tha kryetarja e LSI-së. Apeli i kryetares së LSI-së vjen në kohën kur për shkak të krizës sociale të shkaktuar nga tërmeti, opozita i ka dhënë një lloj "armëpushimi" qeverisë.

Liberalizimi i vizave, premtim që nuk po përmbushet

Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka thënë se Kosova i ka përmbushur kushtet për liberalizim të vizave. Ai ka pohuar se tani kjo është çështje politike e zhvillimeve të brendshme të Evropës dhe nuk lidhet me taksën që Kosova i ka vendosur Serbisë. Haradinaj ka thënë për "Epokën e re" se nëse Kosova nuk hyn në agjendë në mbledhjen e parë të Këshillit të BE-së, që mbahet në fund të shkurtit apo në fillim marsit të këtij viti, atëherë dihet se kjo po bëhet me qëllim dhe dihet që është agjendë për ta mbajtur të izoluar. Edhe ish-ministri i Punëve të Jashtme, aktualisht zëvendëskryeministër, Enver Hoxhaj, mendon se liberalizimi i vizave nuk ndërlidhet me mospunën e institucioneve të Kosovës

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 7 JANAR - Për afërsisht dhjetë vjet rresht liderët politikë në Kosovë kanë premtuar liberalizimin e vizave. Edhe gjatë vitit që lamë pas kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, pati premtuar se në fund të vitit 2019 do ta marrin vendimin pozitiv të vendeve anëtare të BE-së. Por, ngjashëm me vitet e tjera, edhe viti 2019 u përmbyll pa liberalizim të vizave, që nënkupton se qytetarët e Kosovës vazhdojnë të mbesin të vetmit në Ballkanin Perëndimor pa lirinë e lëvizjes pa viza drejt vendeve anëtare të BE-së.

Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka thënë se Kosova i ka përmbushur kushtet për liberalizim të vizave. "Ne i kemi përmbushur të gjitha kushtet për liberalizim. Tani kjo është çështje politike e zhvillimeve të brendshme të Evropës dhe nuk lidhet me taksën. Ne kriteret i kemi përmbushur. Vendet lidere të BE-së, si Gjermania, e kanë marrë iniciativën për të ecur përpara. Nuk ka ndodhur izolim për shkak të taksës, përkundrazi

Kosova është imponuar me këtë fuqi të veten të marrë vendime sovraane", ka thënë Haradinaj për "Epokën e re".

Ai ka theksuar se kjo çështje nuk do të shkojë në pakufi. "Mua më vjen keq prej qytetarëve që po na bëhet një e padrejtë e tillë nga Evropa. Nuk duhet të mbahen të izoluar dy milionë njerëz të Kosovës kur Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet. Këtë e ka konstatuar Komisioni i BE-së dhe për këtë ka votuar Parlamenti i BE-së, ndërsa tani është Këshilli i BE-së që duhet të vendosë", është shprehur Haradinaj, duke shtuar se nëse Këshilli i BE-së nuk e vendos në rend dite në mbledhjen e parë të këtij viti atëherë, sipas tij, vërtet janë duke u sjell keq me Kosovën dhe me qytetarët e saj. "Nëse nuk hyjmë në agjendë në mbledhjen e parë të Këshillit të BE-së, që mbahet diku në fund të shkurtit apo në fillim marsit, atëherë dihet se po bëhet kjo me qëllim dhe dihet që është agjendë për të na mbajtur të izoluar. Për këtë duhet të na tregojnë pse po ndodh kjo", ka deklaruar Haradinaj.

I pyetur nëse liberalizimi është



ndërlidhur me procesin e dialogut me Serbinë, Haradinaj ka thënë se ky proces është kontratë mes Kosovës dhe BE-së. "Edhe liberalizimi i vizave është kontratë Kosovë - BE. Ata i kanë vendosur kushtet, ne i kemi plotësuar ato, ndërsa atyre u ka mbetur marrja e vendimit në Këshill. Çdo temë e ka rëndësinë e vet, por liberalizimi është një kontratë në vete. Ata mund të arsyetohen në mënyra të ndryshme për të mos na dhënë liberalizimin, por është e pakuptimtë t'ua bëjnë këtë të padrejtë dy milionë evropianëve", ka thënë Haradinaj.

Edhe ish-ministri i Punëve të Jashtme, aktualisht zëvendëskryeministër në detyrë, Enver Hoxhaj, nuk mendon se liberalizimi i vizave ndërlidhet me mospunën e institucioneve të Kosovës. "Nuk mendoj se

liberalizimi i vizave ndërlidhet me mospunën tonë. Mendoj se si qeveri dhe fakti që edhe partnerët e koalicionit dhe ata që kanë kundërshtuar ratifikimin dhe, po ashtu, ata që e kanë shpikur si temë, në fund e kanë votuar. Çdokush duhet ta dijë se ne si Kosovë kemi plotësuar çdo standard të mundshëm për liberalizimin e vizave", është shprehur Hoxhaj.

Ai ka thënë se liberalizimi i vizave nuk ka pasur ndërlidhje me taksën që ka vendosur Kosova ndaj Serbisë? "Absolutisht jo, mirëpo mënyra se si BE-ja e ka trajtuar Kosovën dhe mënyra se si disa shtete anëtare e kanë trajtuar Kosovën ka qenë e padrejtë dhe ka dëmtuar edhe kredibilitetin e BE-së në Kosovë. Prandaj ne i kemi kryer të gjitha punët që janë vlerësuar prej Komisionit Evropian. Parlamenti

Evropian ka miratuar raportin dhe mandej vendimarrja është bllokuar te shtetet anëtare, më shumë për shkak të politikave të tyre të brendshme populiste dhe më shumë për shkak të mosinteretit që të merren me tema serioze në Ballkan, por nuk mund të fajësohet askush në Kosovë në vitin 2019 për atë që Kosova nuk i ka përmbushur standardet për liberalizim", ka thënë Hoxhaj për "Epokën e re".

Për tri vjet rresht liberalizimi i vizave për Kosovën ishte kushtëzuar nga BE-ja me ratifikimin e Marrëveshjes së demarkacionit ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi. Por, edhe pse Kuvendi i Kosovës, ndonëse me tri vjet vonesë arrii ta ratifikonte demarkacionin, BE-ja më pas nuk arriti konsensusin e brendshëm për t'ua hequr vizat qytetarëve të Kosovës.

Vlora Çitaku: Jemi të bekuar me relacionin e veçantë që kemi me ShBA-në

PRISHTINË, 7 JANAR - Ambasadorja e Kosovës në ShBA, Vlora Çitaku, ka thënë se komuniteti shqiptar në ShBA ka dhënë një kontribut jashtëzakonisht të madh në Amerikë. Në një intervistë në 'Ora shtatë' në 'Klan Kosova', Çitaku ka thënë është një barrë e rëndë të jesh ambasadore e një vendi të vogël në një vend të madh. "Kemi një komunitet shqiptar jashtëzakonisht aktiv dhe i suksesshëm. Bile shqiptarët edhe kur ka ndodhur lufta kanë dhënë edhe jetën e tyre. Kemi rastin e vëllezërve Bytyqi që kanë ardhur nga

Amerika për të luftuar në Kosovë", ka thënë ajo.

Çitaku ka theksuar se shqiptarët në Amerikë mbajnë pozita të rëndësishme. "Vetëm në zgjedhjet lokale i kemi 6 shqiptarë që kanë fituar atje. Ne duhet ta mirëmbajmë këtë miqësi në vazhdimësi. Liria dhe pavarësia jonë është produkt i rezistencës sonë, por do të ishte e vështirë të arrihet pa miq. Kemi pasur fat që jemi në relacione të shkëlqyera me ShBA-në, por ky relacion duhet të kultivohet", ka thënë Çitaku.





FLET PËR "EPOKËN E RE", ARTAN MURATI

TË SHTERËN TË GJITHA MUNDËSITË KUSHTETUESE PARA SE TË MENDOHEM PËR ZGJEDHJE

Analisti politik Artan Murati ka deklaruar se është e papranueshme të flitet për zgjedhje të reja vetëm pse LV-ja dhe LDK-ja nuk arrijnë t'i tejkalojnë dallimet e vogla për pozita të caktuara. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se Kushtetuta e Kosovës e njeh edhe mundësinë e mandatimit të një kandidati tjetër për kryeministër nëse dështon mandatarin e parë. Murati ka vlerësuar se duhet të shterëni të gjitha mundësitë kushtetuese dhe reale para se të mendohet për zgjedhje të reja. Sipas tij, LV-ja dhe LDK-ja duhet të jenë realiste në kërkesa për ta arritur një marrëveshje për bashkëqeverisje

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 7 JANAR - Analisti politik Artan Murati ka bërë me dije se vendi nuk ka nevojë për zgjedhje të reja. Ai ka deklaruar se është humbje kohe dhe degradim i një procesi të mirëfilltë zgjedhor nëse shkohet përsëri në zgjedhje të parakohshme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Murati ka thënë se duhet të shterëni të gjitha mundësitë kushtetuese e reale para se të mendohet për zgjedhje. "Është e papranueshme të flitet për zgjedhje të reja tre muaj pas një procesi të rregullt zgjedhor, vetëm pse subjektet politike nuk

arrijnë t'i tejkalojnë dallimet e vogla për pozita të caktuara. Kushtetuta e Republikës së Kosovës e njeh edhe mundësinë e mandatimit të një kandidati tjetër për kryeministër nëse dështon mandatarin e parë. Konsideroj se duhet të shterëni të gjitha mundësitë kushtetuese e reale para se të mendohet për zgjedhje sepse nuk kemi kaq shumë kohë për të humbur", ka thënë Murati. Ai ka deklaruar se Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës e kanë për obligim të arrijnë një marrëveshje bashkëpunimi për ta çuar në vend vullnetin e rreth 500 mijë votuesve të cilët votuan më 6 tetor. Sipas Muratit, të dy

këto subjekte politike duhet të jenë realiste në kërkesat e tyre. "Nëse ka vullnet për ta shtyrë procesin përpara, e sidomos nëse reflektohet në vullnetin qytetar të 6 tetorit, sigurisht se mund të tejkalohen dallimet aktuale dhe mund t'i hapet rrugë një marrëveshjeje për bashkëqeverisje mes dy palëve. Që të dy subjektet duhet të jenë realiste në kërkesa. LV-ja nuk është fituese absolute e zgjedhjeve, e LDK-ja nuk i ka fituar ato. Pra, para se të ketë kërkesa maksimaliste nga të dyja palët, duhet të reflektohet në rezultatin real të zgjedhjeve. Kjo do ta lehtësonte arritjen e një marrëveshjeje të koalicionit", është shprehur Murati.

pasuar me kryeneçësi, kanë lënë peng procesin e bashkëpunimit mes të dyja subjekteve. Qasja të cilën që të dyja subjektet politike e kanë aktualisht është e gabuar dhe lë pak hapësirë për të pasur mundësi bashkëpunimi të sigurtë. Qytetarët e Republikës së Kosovës qartazi kanë shprehur vullnetin e tyre më 6 tetor, por ky vullnet ende nuk u materializua me një marrëveshje të mirëfilltë bashkëpunimi.

"Epoka e re": *Negociatat mes këtyre dy subjekteve politike kanë ngecur pas veprimit të njëanshëm të LV-së për ta propozuar dhe zgjedhur kryeparlamentarin, i cili parashihej t'i takojë LDK-së. Si e keni parë këtë veprim?*

Murati: Në fakt, çështja e zgjedhjes së kryeparlamentarit ishte paksa e çuditshme dhe konfuze jo vetëm për publikun, por edhe për vetë deputetët e LDK-së dhe LV-së. Propozimi i z. Konjufca si kryeparlamentar në esencë është në rregull, sepse z. Konjufca e njeh mirë punën e Kuvendit dhe konsideroj që si kryeparlamentar do të bëjë një punë të mirë. Megjithatë, ky veprim i Lëvizjes Vetëvendosje pa dyshim se ka konsekuenca politike në raport me LDK-në. Ky post veçse ishte marrë vendim që t'i takonte LDK-së, e marrja e tij nga LV-ja pa dyshim se ndryshon edhe rrjedhën e negociatave mes tyre.

Tani normalisht se apetitet e LDK-së do të rriten dhe, me gjasë, pozita e presidentit tanimë është e pashmangshme në kalkulimet politike mes dy palëve. Propozimi i fundit i z. Kurti për ndarjen e barabartë të numrit të ministrive dhe pa postin e kryeparlamentarit, e vështirëson edhe më tej një pajtim mes të dyja palëve. Vlen të përmendet si shumë pozitiv veprimi i LDK-së për votimin e kryeparlamentarit, sepse kështu u krijua mundësia e konstituimit të legjislaturës së shtatë dhe nuk ndodhën skenarë të bllokadave e lojërave të panevojshme politike.

"Epoka e re": *Kanë kaluar javë që liderët e këtyre dy subjekteve politike nuk kanë komunikuar. A është ende e mundur një marrëveshje mes tyre dhe si*

"Epoka e re": *Z. Murati, edhe tre muaj pas zgjedhjeve ende nuk kemi një marrëveshje për bashkëqeverisje në mes të LV-së dhe LDK-së. Pse mendoni se po ndodh kjo?*

Murati: Arsyeya kryesore përse edhe pas tre muajsh nga zgjedhjet e 6 tetorit nuk kemi institucione funksionale është kryekëput politike, më konkretisht pamundësia e LV-së dhe LDK-së për të arritur një marrëveshje të bashkëpunimit. Siç duket, që të dyja këto subjekte politike nuk po arrijnë ta ndërtojnë konsensusin e nevojshëm për ta finalizuar marrëveshjen e koalicionit, e cila fillimisht u duk se mund të arrihej shpejt, sidomos pas përafrimit të programit qeverisës mes dy palëve. Veprime të njëanshme,



S'KA MARRËVESHJE LV - LDK, SOT TAKOHEN PËRSËRI KURTI DHE MUSTAFA

"Epoka e re"

PRISHTINË, 7 JANAR - As takimi i parë në këtë vit i liderit të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, me liderin e LDK-së, Isa Mustafa, nuk ka sjellë ndonjë rezultat në drejtim të arritjes së një marrëveshje për bashkëqeverisje. Pas disa orë diskutimesh, ata janë pajtuar që të takohen përsëri sot (e mërkurë) për t'i vazhduar bisedimet.

mund të arrihet ajo?

Murati: Konsideroj se një marrëveshje në mes të LV-së dhe LDK-së është e mundur dhe se ka kohë të mjaftueshme për të ndodhur. Elementi më pozitiv në raport me të dyja subjektet është harmonizimi i programit qeverisës, pra puna e madhe për bashkëpunim potencial veçse ka përfunduar me sukses. Ndasitë mes të dy palëve janë kryekëput politike dhe nëse ka vullnet për ta shtyrë procesin përpara, e sidomos nëse reflektohet në vullnetin qytetar të 6 tetorit, sigurisht se mund të tejkalohen dallimet aktuale dhe mund t'i hapet rrugë një marrëveshjeje për bashkëqeverisje në mes të dyja palëve. Që të dyja subjektet duhet të jenë realiste në kërkesa. LV-ja nuk është fituese absolute e zgjedhjeve, e LDK-ja nuk i ka fituar ato. Pra, para se të ketë kërkesa maksimaliste nga të dyja palët, duhet të reflektohet në rezultatit real të zgjedhjeve. Kjo do ta lehtësonte arritjen e një marrëveshjeje të koalicionit.

"Epoka e re": *Lideri i LV-së, Albin Kurti, ka filluar konsultimet me presidentin, por nuk është mandatuar ende. Sa*

Liderët e partive politike nuk kanë folur pas takimit për medie, ndërsa zëdhënësi i LDK-së, Besian Mustafa, ka treguar për takimin e radhës në mes të liderëve, por pa treguar orën. "Jemi pajtuar që nesër të mbahet edhe një takim. Për orën e saktë të takimit ju njoftojmë nesër paradite", ka thënë shkurt Mustafa.

Në këtë takim lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka qenë i shoqëruar nga tre nënkryetarët e partisë, Vjosa Osmani, Agim Veliu

dhe Lutfi Haziri.

Takimi i parë në mes të liderëve të LV-së dhe LDK-së, pas zgjedhjes së Glauk Konjufcës kryeparlamentar, ka ndodhur një ditë pasi Albin Kurti ka takuar presidentin Hashim Thaçi për çështjen e mandatarit. Shefi i shtetit të hënën i ka dhënë 48 orë shtesë LV-së për ta propozuar kandidatin për kryeministër. Në të kundërtën, presidenti ka paralajmëruar se do ti ndërmarrë veprimet e parapara kushtetuese.

besoni se mund të zgjasë kjo kohë?

Murati: Çështja e mandatimit më tepër po duket si blerje kohe sesa proces që njëmend është duke ndodhur. Është krejtësisht e qartë kush është i mandatuari i LV-së për kryeministër. Këtë e dinë të gjithë qytetarët e vendit, e normalisht edhe presidenti Thaçi. Mirëpo, meqenëse ende nuk ka një marrëveshje me LDK-në dhe, duke pasur parasysh faktin se afati kushtetues për votim të kabinetit qeveritar në Kuvend fillon të rrjedhë pas mandatimit formal nga presidenti, LV-ja është duke e shfrytëzuar këtë periudhë për të blerë sa më shumë kohë për të arritur një marrëveshje me LDK-në. Kjo, në fakt, nuk ka asgjë të keqe, sepse gjithçka është duke u zhvilluar brenda afateve dhe kornizave kushtetuese.

"Epoka e re": *Nëse nuk ndodh ndonjë marrëveshje në mes të LV-së dhe LDK-së, cila është alternativa. Zgjedhje të reja, apo ndonjë qeveri teknike?*

Murati: Konsideroj se nuk ka nevojë për zgjedhje të reja. Është humbje kohe, shpenzim i panevojshëm e, mbi të gjitha,

degradim i një procesi të mirëfilltë zgjedhor siç ndodhi më 6 tetor. Rezultati është i qartë, vullneti i qytetarëve të vendit po ashtu. Është e papranueshme të flitet për zgjedhje të reja tre muaj pas një procesi të rregullt zgjedhor, vetëm pse subjektet politike nuk arrijnë t'i tejkalojnë dallimet e vogla për pozita të caktuara. Kushtetuta e Republikës së Kosovës e njeh edhe mundësinë e mandatimit të një kandidati tjetër për kryeministër nëse dështon i mandatuari i parë. Konsideroj se duhet të shterë të gjitha mundësitë kushtetuese e reale para se të mendohet për zgjedhje, sepse nuk kemi kaq shumë kohë për të humbur. Nëse do të kishte zgjedhje të reja, Kosova me gjasë do të mbetej pa institucione funksionale deri në maj. Për më tepër, mbajtja e zgjedhjeve pa reformë zgjedhore rrezikon përsëritjen e anomalive të shfaqura në zgjedhjet e fundit të cilat ndikuan në vonesa të mëdha deri në certifikimin e rezultateve. Pra, LV-ja dhe LDK-ja e kanë për obligim që të arrijnë një marrëveshje bashkëpunimi, për ta çuar në vend vullnetin e afro 500 mijë votuesve kosovarë të cilët votuan më 6 tetor.



Kërkesa të shumta të pacientëve për trajtim mjekësor jashtë Kosovës

PRISHTINË, 7 JANAR- Rreth 1 200 pacientë kanë përfituar nga programi për trajtim mjekësor jashtë institucioneve publike shëndetësore të Kosovës. Ndërkohë, rreth 200 pacientëve u janë refuzuar kërkesat për përfitime nga ky fond, i cili kap shumën prej 6 milionë eurosh në vit.

Këto informacione për "Radion Evropa Lirë" i ka konfirmuar Bardhyl Jerliu, udhëheqës i Divizionit për Trajtim Mjekësor jashtë institucioneve publike shëndetësore. "Nga 1369, sa është numri i pacientëve të cilët kanë aplikuar për përkrahje financiare për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike gjatë vitit 2019, kanë përfituar rreth 1 200 pacientë", thotë Jerliu.

Ai ka treguar edhe për klinikat të cilat më shpesh i referojnë pacientët për shërim jashtë institucioneve publike shëndetësore për shkak të pamundësisë së trajtimit të tyre në Kosovë. "Klinikat të cilat më së shumti i referojnë pacientët për trajtim jashtë Kosovës janë ata me probleme oftalmologjike apo sëmundjet e syve, pastaj pediatria, fëmijët



me probleme në zemër, pra sëmundjet kardiokirurgjike, sëmundjet malinje, pastaj ortopedia, otorinolaringologjia e hemato-onkologjia", ka thënë Jerliu. Por, sipas Bankës Botërore, llogaritet se janë edhe 140 milionë euro të cilat qytetarët e Kosovës i shpenzojnë për trajtimin e sëmundjeve të ndryshme jashtë vendit.


Blerim Sylja, udhëheqës i Federatës Sindikale të

Shëndetësisë, thotë se shifrat e Bankës Botërore janë zyrtare dhe të verifikuara por, sipas tij, shumica reale e parave që shpenzojnë qytetarët e Kosovës për nevojat të trajtimit shëndetësor është shumë më e lartë. "Këto janë shifra të Bankës Botërore, por ne e dimë se janë edhe shumë qytetarë që nuk deklarohen dhe shpenzojnë shumica të mëdha e që parashihet se

arrin deri në 200 milionë euro. Kardiologjia dhe Kardiokirurgjia gjatë vitit 2019 kanë kursyer deri pesë 5 milionë euro buxhetin e shtetit, prej kur janë funksionalizuar edhe shërbimet për trajtimin e sëmundjes së zemrës, shërbime këto që qytetarët i kanë marrë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës", ka thënë Sylja. Njëra nga pacientet e cila nuk

ka përfituar nga ky fond është Blerina. Ajo kishte vendosur që gjatë muajit dhjetor të vitit 2019 të udhëtonte në një shtet jashtë Kosovës për ta marrë trajtimin e nevojshëm mjekësor për sëmundjen e kancerit, pasi që ai trajtim nuk aplikohet në Kosovë. "Hemoterapia aplikohet në Kosovë, por jo edhe disa terapi të tjera, e njëjren që unë është dashur ta marr nuk aplikohet në vend. Kjo është edhe arsyeja që kam vendosur të shkoj jashtë vendit. Këtu kanë thënë se deri në vitin e ardhshëm nuk aplikohet terapia që unë duhet ta marr. Njëkohësisht nuk e kanë lëshuar as dokumentin që unë kam nevojë të trajtohem jashtë. Dhe si familje kemi vendosur të shkojmë me mjete vetjake, e që ende nuk e di as sa kushton", ka thënë Blerina kohë më parë për "Radion Evropa e Lirë". Sidoqoftë, pacientët shpeshherë kanë kërkuar shërbime jashtë Kosovës edhe nëse të njëjtat ofrohen në Qendrën Klinike Universitare, pasi që janë ankuar në cilësinë e ofrimit të atyre shërbimeve.

Nga 2 shkurti ngritet çmimi i vizave Shengen



PRISHTINË, 7 JANAR - Nga 2 shkurti i këtij viti të gjithë ata që synojnë të aplikojnë për vizë Shengen do të jenë të detyruar të paguajnë taksë 33.3 për qind më shumë. Kjo i bie që aplikuesit për vizë do të duhet të paguajnë 80 euro dhe jo 60 sa është aktualisht. Përveç çmimit, do të ndryshojë edhe një prej rregullave të aplikimit. Ata të cilët do të dëshirojnë të vizitojnë ndonjë prej vendeve të Zonës Shengen mund të aplikojnë për vizë 6 muaj më herët nga koha kur planifikojnë të udhëtojnë, pasi aktualisht aplikimi mund të bëhet vetëm 3 muaj më herët. Ky ndryshim i Rregullores për viza është miratuar nga Këshilli i Bashkimit Evropian në qershor të vitit 2019 dhe do

të aplikohet në të gjitha shtetet anëtare të BE-së dhe vendet e tjera që janë pjesë e Marrëveshjes për Shengen. Një rregullore të tillë disa prej shteteve të BE-së kanë konfirmuar se do të fillojnë ta zbatojnë në periudhën e njëjtë. Për "SchengenVisaInfo.com" një gjë të tillë e kanë pohuar Lituania, Gjermania, Danimarka, Finlanda e Belgjika. Përveç këtyre, sipas kësaj rregullore të re që do të zbatohet nga shkurti i këtij viti, shtetet anëtare do të jenë të detyruara të hapin qendra për procesim të vizave në vendet ku nuk kanë përfaqësi, në mënyrë që aplikantët të mos të detyrohen të udhëtojnë në shtete të tjera vetëm për të aplikuar.

Myftiu Tërnavë shkon për vizitë zyrtare në Arabinë Saudite

MEKË, 7 JANAR (ER)- Me ftesë të sekretarit gjeneral të Ligës së Botës Islame RABITA-s, dr. Muhamed Abdulkerim Alisa, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiu Naim ef. Tërnavë, po merr pjesë në mbledhjen e 44 të Këshillit të lartë të RABITA-s. Në këtë mbledhje ishin

të pranishëm anëtarët e Këshillit të lartë të RABITA-s, në mesin e tyre myftiu, ministra, ulema dhe dijetarë të shquar të botës islame si dhe personalitete fetare të ndryshme udhëheqëse të botës islame.

Në mbledhje u diskutuan çështje të shumta të botës islame, ndikimi

i tyre dhe roli i liderëve fetarë, si dhe u diskutuan edhe çështjet bashkëkohore fetare. Gjithashtu, u themelua edhe shpërblimi i Institutit Islamik të Fikhut për hulumtim, me të cilin do të shpërblehen institucionet, iniciativat dhe organizatat të cilat merren me studime të çështjeve të fikhut.



Ushtria e Kosovës, me objektiva të qarta për vitin 2020

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletenant Rrahman Rama, ka bërë me dije se ky vit do të jetë më shumë i fokusuar në trajtimin dhe zhvillimin profesional të të gjitha njësive të FSK-së, duke marrë parasysh mandatin dhe misionin e ri të saj. Ai ka theksuar se tanimë FSK-ja është shumë më e përgatitur, më e trajnuar dhe shumë më mirë e pajisur



ndërtojmë ato kapacitete trajnuese që janë të nevojshme për misionin dhe mandatin e ri. Për këtë do të kemi përkrahje edhe nga ana e partnerëve tanë dhe nuk shoh ndonjë sfidë", ka thënë Rama, duke shtuar se këtë

vit do të vijë pajisje të reja të mbrojtjes për FSK-në. "Në vitin 2020 pritet të arrijnë ato pajisje, sepse pajisjet e mbrojtjes janë pak më specifike dhe kanë procedura kohore të posaçme që marrin kohë deri të prodhohen duke u bazuar në kërkesat tona. E rëndësishme është që në 2019-n i kemi përmbyllur nevojat dhe kërkesat në bazë të mundësisë buxhetore. Pra, kemi nënshkruar kontrata të rëndësishme dhe rezultatet do të shihen këtë vit", ka deklaruar komandanti i FSK-së, gjeneralletenant Rrahman Rama. Ai ka theksuar se tanimë FSK-ja është shumë më e përgatitur, më e trajnuar dhe shumë më mirë e pajisur. Rama ka shtuar se një e arritur tjetër që kanë pasur në vitin që lamë pas ka qenë rekrutimi i 700 ushtarëve të rinj, ku janë kryer edhe trajnimet bazike. "Kemi arritur që edhe 200 të tjerë t'i kthejmë nga komponenti rezervë në atë aktiv. Pra, FSK-ja vitin 2019 e ka përmbyllur me 900 ushtarë të rinj", ka bërë me dije Rama. Forca e Sigurisë së Kosovës

(FSK) edhe në vitin 2019 doli të jetë institucioni më i besueshëm i sigurisë për qytetarët e Kosovës.

Forca e Sigurisë së Kosovës, sipas këtij barometri, shihet si institucioni më së paku i korruptuar në nivel të Kosovës. Ky rezultat pa dyshim është pasqyrim i aktiviteteve dhe punës me përkushtim të lartë për realizimin e detyrave të planifikuara nga Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës.

Më 14 dhjetor të vitit 2018 Kuvendi i Kosovës ka miratuar tri ligjet me të cilat mundësohet transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës në Ushtri të Kosovës. Ndonëse emri i FSK-së nuk pëson ndryshime për shkak të pamundësive për ndryshime kushtetuese, ligjet e miratuara vlerësohet se i japin FSK-së kapacitete ushtarake gjatë një procesi transformimi brenda disa viteve. Bëhet fjalë për Ligjin për Ministrinë e Mbrojtjes, atë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ligjin për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 JANAR - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletenant Rrahman Rama, ka bërë me dije se në vitin 2020 kjo forcë ka disa objektiva para vetes. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se ky vit do të jetë më shumë i fokusuar në trajtimin dhe zhvillimin profesional të të gjithë njësive të FSK-së, duke marrë parasysh mandatin dhe misionin e ri. "Edhe për vitin 2020 i kemi objektivat e qarta. Ne kemi një plan gjithëpërfshirës të zhvillimit. Pra, kemi planin në detaje për

secilën njësi se çfarë detyra dhe obligime ka si në kuptimin e ngritjes profesionale, të pajisjeve, infrastrukturës dhe të gjitha elementeve të tjera. Domethënë, prioritetet tona do të jenë të bazuara në objektivat strategjike të ministrisë dhe ne jemi të obliguar që ato objektiva strategjike t'i realizojmë, duke u bazuar në planin tonë gjithëpërfshirës. Ky vit do të jetë më shumë i fokusuar në trajtimin dhe zhvillimin profesional të të gjithë njësive, duke marrë parasysh mandatin dhe misionin e ri. Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (TRADOK) do të jetë prioriteti yni sepse do t'i



Liderët urojnë besimtarët ortodoksë për Krishtlindjen

PRISHTINË, 7 JANAR (ER) - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka uruar të gjithë besimtarët ortodoksë për festën e Krishtlindjes, duke iu dëshiruar vit me mirëqenie më të mirë për komunitetin ortodoks. "Kjo festë e shpresës le të shërbejë për ta treguar shpirtin human dhe për t'u solidarizuar me njëri-tjetrin, duke fuqizuar vlerat e të gjitha komuniteteve në vendin tonë. Paqe, harmoni dhe lumturi në çdo familje tuajën!", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook". Edhe kryeministri Ramush

Haradinaj ka uruar besimtarët ortodoksë. "Të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës të besimit ortodoks, por edhe miqve dhe bashkëpunëtorëve të po këtij besimi, ua uroj festën e Krishtlindjes, me dëshirat me të mira për të gjithë", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka uruar besimtarët ortodoksë për festën e Krishtlindjes, duke uruar për më shumë paqe, mbarësi, begati, tolerancë e respekt ndërnjerëzor. "Uroj që kjo ditë

festë të shërbejë si motiv shtesë për t'i shpalosur ndjenjat e dashurisë ndaj njëri-tjetrit, të respektit ndaj besimeve të ndryshme në Republikën tonë e të angazhimit për të punuar së bashku për ndërtimin e një të ardhmeje më të begatë, në paqe e harmoni", është thënë në urimin e kryetarit të Kuvendit, Glauk Konjufca.

Besimtarët ortodoksë i ka uruar edhe lideri i LV-së, Albin Kurti, ai i LDK-së, Isa Mustafa, kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj dhe kryetari i AKR-së, Behgjet Pacolli.



Brenda një viti rreth 2 000 raste të tentim-kontrabandës me mallra

PRISHTINË, 7 JANAR- Autoritetet doganore të Kosovës thonë se përgjatë vitit 2019 kanë evidentuar rreth 2 000 raste të kontrabandës me mallra të ndryshme. Vlera e mallit që është tentuar të hyjë si kontrabandë përmes pikave kufitare dhe në kufirin e ashtuquajtur 'vija e gjelbër', sipas përfaqësuesve të Doganës së Kosovës arrin në rreth 10 milionë euro. Pjesa veriore e Kosovës, e cila shtrihet në kufi me Serbinë, sipas Doganës së Kosovës, ka qenë një nga zonat më të prekura nga kontrabanda. Drejtori i përgjithshëm i Doganës së Kosovës, Bahri Berisha, tha për "Radion Evropa e Lirë" se që gjatë vitit 2019 kanë zbuluar rreth 1 800 kundërvajtje doganore dhe kanë ngritur 100 kallëzime penale për vepra që lidhen me kontrabandë me mallra. "Trendi i kontrabandës është përafërsisht i njëjtë me vitin e kaluar, por kemi një rritje të zbulimeve të rasteve të kontrabandës. Bazuar në informacionet që i kemi pasur në vendet me rrezikshmëri të lartë kemi arritur ta parandalojmë kontrabandën, që kryesisht në

Kosovë futet përmes rrugëve malore. Vlera e kontrabandës, bazuar në mallrat e konfiskuara gjatë vitit 2019, arrin në rreth 10 milionë euro", ka pohuar Berisha.

Në vitin e kaluar Policia e Kosovës kishte zhvilluar një operacion në veri dhe jug të Mitrovicës, që kishte për qëllim luftimin e krimit dhe kontrabandës. Si rezultat i këtij operacioni ishin arrestuar 25 persona.

Produktet më atraktive, të cilat kontrabandohen në Kosovë, janë mallrat për të cilat paguhet akciza, siç janë nafta, alkooli dhe duhani. Por, pas vendosjes së taksës 100 për qind për importet dhe produktet me orgjinë nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina, sipas Berishës, është tentuar të kontrabandohen edhe mallrat ushqimore. "Që nga aplikimi i masave mbrojtëse (taksës), nga nëntori i vitit 2018, kemi vërejtur se disa produkte që më herët nuk janë kontrabanduar, siç janë produktet ushqimore, për shkak të masave mbrojtëse, ka pasur tentim të kontrabandimit të tyre, por falë krijimit të task-forcave të përbashkëta



me Policinë e Kosovës dhe agjencitë e tjera kemi arritur t'i zbulojmë rreth 350 raste të tentim-kontrabandës së këtyre produkteve nga Serbia dhe Bosnja", thotë Berisha.

Dogana e Kosovës është kontribuuesja kryesore e buxhetit të shtetit, e cila grumbullon për arkën e vet tri tatime kryesore: Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në import, taksën doganore dhe akcizën.

Përfaqësues të bizneseve thonë se nga hulumtimet që kanë bërë taksë mund të ketë

ndikuar në rënien e nivelit të kontrabandës. Kryetari i Aleancës Kosovare të Biznesit, Agim Shahini, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se, bazuar në një studim të kësaj Aleance, del se taksa ka ndikuar pozitivisht në rënien e kontrabandës në veri të vendit. "Sipas këtij studimi, rreth 100 milionë euro ka pasur mallra të kontrabanduara nga Serbia në Kosovë në vitin 2017 dhe 2018, kurse tani ky nivel ka rënë dukshëm. Kjo ka qenë një kontrabandë e lehtë në

krahasim me kontrabandën që ka pasur nëpër vijat e rregullta ku kanë hyrë maune të pakontrolluara, maune me vlera të mëdha dhe tani hyjnë në sasi të vogla, me makina të vogla", thotë ai.

Me rënien e nivelit të kontrabandës, thotë Shahini, është mundësuar një konkurrencë më e barabartë në treg. Më 6 nëntor të vitit 2018 Qeveria në largim e Kosovës vendosi taksën prej 10 për qindësh për prodhimet me origjinë nga Serbia dhe Bosnjë

Gjermania ka nevojë për 260 000 punëtorë të rinj

PRISHTINË, 7 JANAR- Nga 7 janari shqiptarët do të mund të punojnë legalisht në Gjermani vetëm me dokumente të shteteve të tyre dhe kjo vlen për qytetarë të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës.

Gjermania ka nevojë për të paktën 260 000 punëtorë të rinj emigrantë çdo vit për t'i përmbushur nevojat e veta. Këtë herë shteti i njohur për "vjeljen" e infermierëve shqiptarë është duke kërkuar punëtorë për korrjen e asparagut.

Punëtorët mund të fitojnë deri në 150 euro në ditë.

Ky informacion është shpallur zyrtarisht nga kancelarja Angela Merkel, ku thotë se qytetarët do të mund të punojnë në vendin më të zhvilluar të BE-së.

"Deutsche Welle" shkruan se qëllimi i kësaj pakete është t'ua lehtësojë emigrimin ekonomik në Gjermani shtetasve të huaj me origjinë nga jashtë BE-ja dhe kjo ndodh për shkak se Gjermania ka mungesa të mëdha për punëtorë të kualifikuar.





BQK-ja: Asetet e sistemit financiar arrijnë vlerën 7 miliardë euro

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 7 JANAR- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka njoftuar se gjatë tremujorit të tretë të vitit 2019 asetet e sistemit financiar vazhduan trendin e rritjes duke shënuar rritje vjetore prej 12.5 përqindësh dhe duke arritur vlerën prej 7 miliardë eurosh në fund të periudhës raportuese. Sipas BQK-së, kontributin kryesor të zgjerimit të aktivitetit të sistemit financiar vazhdon ta ketë sektori bankar, pasur nga sektori pensional. "Rritja e aseteve të sektorit bankar u mundësua kryesisht nga rritja e aktivitetit kreditues, që erdhi si rezultat i kërkesës së rritur për kredi dhe përmirësimit të kushteve të kreditimit. Gjatë TM3 2019, vlera e kredive të lëshuara shënoi rritje, mirëpo krahas tremujorit të tretë të vitit paraprak, kjo vlerë ishte më e ulët, e ndikuar kryesisht nga rënia e kredive për korporatat jofinanciare. Zgjerimi i aktivitetit kreditues u mundësua nga zhvillimet pozitive të depozitave, të cilat vetëm gjatë TM3 2019 u rritën për 310.3 milionë euro", është thënë në raportin e vlerësimit tremujor të zhvillimeve makroekonomike të BQK-së. Referuar këtij raporti, rritje më të theksuar kishin depozitat e ekonomive familjare, pjesa më e madhe e të cilave përbëhet nga depozitat e transferueshme. "Norma e interesit në

depozitat e korporatave jofinanciare shënoi rënie për 0.2 pikë përqindje krahas periudhës së njëjtë të vitit paraprak, ndërsa norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare shënoi rritje të lehtë për 0.04 pikë përqindje. Sektori bankar edhe gjatë TM3 2019 vazhdoi të ketë performancë të mirë si rezultat i rritjes më të lartë të të hyrave krahas shpenzimeve. Rritja e të hyrave në baza tremujore ishte 11.5 përqind, e mundësuar kryesisht nga rritja e të hyrave nga interesit. Në anën tjetër, shpenzimet shënuan rritje më të ngadalësuar prej 4.7 përqindësh", është thënë në raportin e BQK-së.

Sipas këtij raporti, sa i përket shëndetit financiar, sektori bankar vazhdoi të ketë nivel të ulët të kredive joperformuese prej 2.3 përqindësh dhe rritje të mbulueshmërisë së tyre me provizione prej 161.2 përqindësh. "Për më shumë, indikatorët përkatës sugjerojnë që niveli i kapitalizimit dhe likuiditetit të sektorit është në nivel të kënaqshëm. Sektori pensional si sektori i dytë për nga pesha e rëndësisë në sistemin financiar, edhe gjatë këtij tremujori vazhdoi të ketë kthim pozitiv në investime dhe rritje të kontributeve të reja. Këto zhvillime mundësuan rritjen e aseteve në përgjithësi. Sektori i sigurimeve në baza tremujore shënoi përmirësim të aktivitetit bazuar në trendin e rritjes së primeve të shkruara

dhe dëmeve të paguara. Përkundër rezultateve negative financiare në fund të periudhës, vetëm gjatë TM3 2019 fitimi neto shënoi rritje", është thënë në raportin e BQK-së, duke u shtuar se sektori mikrofinanciar u karakterizua me rritje të aktivitetit si për nga ana e aktivitetit kreditues, ashtu edhe nga performanca e realizuar. "Gjatë TM3 2019 në tregun e letrave me vlerë shuma e borxhit të emetuar nga Qeveria e Kosovës ishte 105 milionë euro dhe norma mesatare e interesit në letrat me vlerë ishte 2.11 përqind", është theksuar në raport.

Sipas këtij raporti, deficitin në llogarinë e mallrave arriti vlerën prej 1.26 miliard eurosh deri në shtator 2019, që paraqet një rritje vjetore prej 3.3 përqindësh. Përderisa në vitin 2018 ishte shënuar rënie e eksportit të mallrave dhe përshpejtimi i rritjes së importit, në vitin 2019 është duke u shënuar rritje e eksportit të mallrave dhe rritje më e ngadalësuar e importit. "Kjo ka ndikuar që shkalla e mbulueshmërisë së importeve me eksporte të ketë një përmirësim nga 10.8 përqind sa ishte në shtator 2018 në 11.3 përqind në shtator 2019. Eksporti i mallrave deri në shtator 2019 ka shënuar vlerën prej 288.8 milionë eurosh, që është për 9 përqind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018", është thënë në raportin e BQK-së.

e Hercegovina, kurse më 21 nëntor kjo taksë u ashpërsua në masë prej 100 përqindësh për të gjitha produktet dhe mallrat e importuara nga këto dy shtete.

Para vendosjes së taksës doganore, Serbia ishte eksportuesja më e madhe e produkteve në Kosovë. Ky shtet, para 21 nëntorit të vitit 2018, kur u vendos taksë 100 përqind, gjatë një dite ka eksportuar në Kosovë mallra në vlerë prej rreth 1.2 milion eurosh apo rreth 450 milionë

euro brenda një viti.

Taksa vazhdon të jetë në fuqi, ndërkohë që pritet se çfarë qëndrimi në raport me taksën do të marrë Qeveria e re e Kosovës. Lëvizja Vetëvendosje, si fituese e zgjedhjeve parlamentare të 6 tetorit dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, të cilat priten ta formojnë qeverinë e re, kanë paralajmëruar si mundësi zëvendësimin e taksës me vendosjen e masës së reciprocitetit të plotë ndaj Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës.



Euro e nis vitin me rritje

PRISHTINË, 7 JANAR- Monedha e përbashkët evropiane e ka nisur këtë vit duke fituar pikë ndaj lekut në Shqipëri. Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë një euro është këmbyer të martën me 121.97 lekë, apo rreth 0.20 pikë më shumë. Leku ka humbur pikë ndaj shportës kryesore të monedhave në vend.

Kështu dollari amerikan u këmbye me 108.98 lekë, apo rreth 0.34 pikë më shumë sesa mbylli vitin 2019. Edhe paundi britanik ka fituar terren duke u këmbyer me 0.41 pikë më shumë në kuotën e 143.4 lekëve. Sa i përket frangut zviceran, ai u këmbye me 112.5 lekë, rreth 0.2 pikë më shumë se në mbyllje të vitit 2019.



Komuna e Mitrovicës nis hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2019 - 2027

MITROVICË, 7 JANAR (ER)- Komuna e Mitrovicës respektivisht Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor ka filluar me hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2019 - 2027, sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor të Kosovës 04/L -

174. "Plani Zhvillimor Komunal është plan strategjik multifunksional, i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit të komunës për periudhën 8-vjeçare, andaj Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor është duke mbajtur takime me banorë nga zonat

rurale dhe ato urbane", ka njoftuar Komuna e Mitrovicës. Sipas këtij njoftimi, qëllimi i këtyre takimeve është informimi i qytetarëve rreth ecuresë së këtij plani, mendimet e tyre lidhur me nevojat, sfidat dhe prioritetet për ato vendbanime.



Komuna e Ferizajt nga qeverisja e kaluar trashëgoi mbi 40 milionë euro borxhe

FERIZAJ, 7 JANAR - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka thënë se viti 2019 ka qenë vit i sfidave dhe i sukseseve për komunën që drejton. Sfidë për këtë komunë, sipas Aliut, vazhdon të jetë trashëgimi i borxheve, ndërsa si suksese ka renditur projektin e bashkimit të qytetit që pritet të përfundojë brenda këtij viti dhe ndërtimin e spitalit të Ferizajt.

Aliu në një intervistë për "KosovaPress" ka thënë se edhe gjatë vitit 2019 kanë vazhduar të përballen me problemin e gjendjes financiare, me ç'rast ka theksuar se nga qeverisja e kaluar ka trashëguar mbi 40 milionë euro borxhe.

Dy nga projektet që, sipas Aliut, janë tejet të rëndësishme dhe që kanë filluar të realizohen gjatë vitit 2019, janë ndërtimi i Pallatit të Kulturës dhe



ndërtimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare.

Të dy këto projekte Aliu ka thënë se janë të rëndësishme

për qytetarët e komunës që drejton. Viti 2020 pritet të jetë viti kur do të përfundojë projekti i bashkimit të qytetit, për

çka kreu i Komunës së Ferizajt thotë se punimet janë duke shkuar me një dinamikë më të lartë sesa që është paraparë në

kontratë. Këtë vit kreu i Ferizajt ka thënë se pritet të përfundojë edhe pallati i panairëve dhe sporteve.

Aliu ka folur edhe për ndërtimin e spitalit regional të Ferizajt, për të cilin ka thënë se ka qenë shumë i domosdoshëm për qytetarët e kësaj komune. Sipas tij, bazuar në dinamikën e punimeve projekti në tërësi mund të përfundojë në vitin 2021.

I pari i Ferizajt ka bërë me dije se gjatë dy vjetëve të fundit kanë filluar ndërtimin e 5 shkollave në gjithë komunën e kjo, sipas tij, do t'u mundësojnë nxënësve që të kenë kushte më të mira për mësim. Gjatë vitit që lamë pas, Aliu ka thënë se kanë realizuar edhe shumë projekte të tjera infrastrukturure, siç është ndërtimi i trotuareve, shtrimi i rrugëve me asfalt, ndriçimi i rrugëve dhe shumë projekte të tjera.

Ramosaj takon pronarët e bizneseve të Deçanit

DEÇAN, 7 JANAR (ER)- Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka pritur në takim pronarët e bizneseve të kësaj komune, me të cilët ka diskutuar për preokupimet të cilat i kanë këto biznese. Ramosaj i ka uruar pronarët e bizneseve për Vitin e Ri si dhe ka premtuar se takime të tilla do të organizohen edhe në të ardhmen. "Sot takova pronarët e

bizneseve të Komunës së Deçanit, me ç'rast iu urova Vitin e Ri 2020, qoftë vit i mbarë për secilin, njëkohësisht diskutuam për preokupimet të cilat i kanë këto biznese! Takime të tilla do të organizohen edhe në ditët në vazhdim! Një falënderim të veçantë për bashkëpunimin që kemi çdo herë!", ka thënë Ramosaj pas këtij takimi.



Zbulohet busti i veprimtarit Pjeter Jaku

KLINË, 7 JANAR (ER)- Në fshatin Ranoc të Komunës së Klinës të martën është bërë zbulimi i bustit të veprimtarit dhe atdhetarit Pjeter Jaku, i cili është vrarë më 7 janar 1945 nga pushtuesit serbë. I pranishëm në zbulimin e bustit ishte kryetari i Klinës, Zenun Elezaj, i shoqëruar nga bashkëpunëtorë të komunës, qytetarë dhe familjarë të të ndjerit. Me këtë rast,

kryetari Elezaj ka theksuar se veprat e atdhetarëve të mosnënshtrimit ndaj okupatorit kanë forcuar ndjenjën atdhetare te shqiptarët dhe kanë dhënë për brezat e rinj se si sakrifkohet për lirinë e atdheut.

Po ashtu, Elezaj me bashkëpunëtorë dhe familjarë të të ndjerit kanë bërë homazhe te lapidari i atdhetarit Llesh Gjon Lleshit.

Mosshfrytëzimi i opinionit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND) nga diplomacia e Kosovës

Shkruajnë: Ma. Genc MEKAJ dhe Ma. Valdrin FERIZI

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka filluar punën në vitin 1946 duke zëvendësuar Gjykatën e Përhershme Ndërkombëtare të Drejtësisë e cila kishte funksionuar nga viti 1922. Është organi kryesor gjyqësor i Kombeve të Bashkuara, ndërkaq themelimi dhe funksionimi i saj është i bazuar në statutin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Selinë e saj Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë e ka në Hagë në shtetin e Holandës, mirëpo nëse shihet e arsyeshme, funksionet dhe mbledhjet gjykata mund t'i ushtrojë edhe tjetërkund.

Anglishtja dhe frëngjishtja janë gjuhët zyrtare të Gjykatës.

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë është organi më i rëndësishëm juridik i Kombeve të Bashkuara.

GjND-ja detyrë kryesore ka zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që i parashtrajnë shtetet. Pikërisht në këtë gjykatë u shqyrtua mosmarrëveshja në mes të shtetit të Kosovës dhe të shtetit të Serbisë në lidhje me çështjen e pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Procesi i pavarësimi të Kosovës kaloi nëpër një sërë fazash mjaft komplekse dhe me sfida historike dhe politike. Ndërhyrja dhe ndërmjetësimi i bashkësisë ndërkombëtare në mes të Kosovës dhe Serbisë ishte një proces mjaft i vështirë dhe kompleks i cili lëvizti trajektoren drejt shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare si dhe të Kosovës hasnin në vështirësi të mëdha pikërisht për çështjen që Serbia nuk e pranonte realitetin e ri që Kosova, të cilën dikur e kishte aneksuar padrejtësisht, tani më po ndahej duke kërkuar shpalljen e pavarësisë së saj, e drejtë kjo e garantuar me ligjet dhe të drejtën ndërkombëtare si dhe me theks të veçantë të drejtën për vetëvendosje.

Kështu që Kosova në vitin 2008 shpalli pavarësinë duke u deklaruar si shtet i pavarur dhe sovran si dhe duke përmbushur të gjitha të drejtat dhe kompetencat ligjore-juridike ndërkombëtare.

Serbia në mënyrë të qartë dhe të hapur gjithmonë dhe në vazhdimësi kundërshton dhe lobon kundër pavarësisë së Kosovës duke mos e pranuar në mënyrë kategorike dhe direkte. Serbia me këmbëngulje vazhdon ta quajë Kosovën pjesë të vetën. Po atë vit që Kosova shpalli pavarësinë, disa muaj më vonë Serbia mori hapa që çështjen e pavarësisë së Kosovës ta

paraqiste në GjND (kërkonte mendimin e GjND-së), me qëllim të kontestimit të legjitimitetit të pavarësisë së Kosovës.

Me nismën e Serbisë, Asambleja e Përgjithshme ka miratuar rezolutën 63/3. Me rezolutën 63/3 të miratuar më 8 tetor 2008, Asambleja e Përgjithshme i ka kërkuar Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, organit kryesor gjyqësor të Kombeve të Bashkuara, dhënien e një mendimi këshillëdhënës në pyetjen: nëse Deklarata e Pavarësisë së Kosovës është në pajtim me të drejtën ndërkombëtare. Rezoluta është miratuar me 77 vota për, 6 kundër dhe 74 abstenime.

Mbështetur në nenin 65(2) të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, më 30 janar 2009, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së i ka dorëzuar Gjykatës një dosje me dokumente që mund të hidhnin dritë në pyetjen e kërkuar. Serbia nga ana e saj me këmbëngulje dhe me bindje kategorike bënte thirrje dhe ishte e vendosur që Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë mendimin do ta japë në favor të Serbisë, duke theksuar dhe duke u munduar që të elaborojë që pavarësia e Kosovës është vendimmarrje e padrejtë që bie ndesh me të drejtën ndërkombëtare dhe me Rezolutën 1244 të vitit 1999.

Pas dëgjimit të argumenteve për dhe kundër pavarësisë së Republikës së Kosovës më 22 korrik të vitit 2010 Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë arriti në përfundim se "pavarësia e Kosovës e shpallur më 17 shkurt 2008 nuk ka shkelur ligjet ndërkombëtare, Rezolutën 1244 (1999) dhe as Kornizën Kushtetuese. Përmes këtij konkluzioni bëhet e qartë që Kosova me miratimin e Deklaratës së Pavarësisë nuk shkeli asnjë rregull të drejtës së përgjithshme ndërkombëtare. Pavarësia e Kosovës nuk është ndesh me të drejtën ndërkombëtare dhe se gëzon legjitimitet të plotë". Gjykata u deklarua me 10 vota për dhe 4 kundër.

Opinionin i GjND-së ishte disfatë për Serbinë i cili i dha fund qëllimit dhe shpresës së Serbisë për ta shfrytëzuar Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë si pikënisje drejt negociatave në lidhje me statusin e Kosovës. Qëllimet serbe ishin që përmes marrjes së vendimit të GjND-së të mund të ushtrojnë trysni mbi Kosovën me qëllim të pranimit të negociatave (me kushte të vëna nga Serbia) për statusin e Kosovës, por gjë që nuk doli sipas strategjisë së Beogradit. Serbia ka deklaruar që do ta vazhdojë luftën me mjete ligjore pas këtij vendimi i cili është i rëndë për të. Pozicionin i Beogradit mbështetet



në dy elemente: mosnjohja e pavarësisë së Kosovës, të cilën serbët e quajnë "DNP" (Deklarata e Njëanshme e Pavarësisë) dhe arritja e një kompromisi pa fitues apo humbës absolut. Të dyja qëndrimet janë të lidhura ngushtë me procesin që çoi drejt pavarësisë. "Retorika se kurrë nuk do të pranohet pavarësia e njëanshme e Kosovës, në mediat e Prishtinës dhe ato perëndimore konsiderohet si refuzim për t'u ballafaquar me realitetin". Me gjithë trysnitë dhe deklaramet nga Beogradi, qasja dhe linja për çështjen e Kosovës mund të thuhet se ka filluar të ndryshohet nga ana e Serbisë, duke marrë parasysh zhvillimet brenda Serbisë dhe ndryshimet e një sërë faktorësh të tjerë. Opinioni publik në Serbi është lodhur nga problemi i Kosovës dhe dëshiron që kjo të përfundojë edhe pse ka gjasë që elementët nacionalistë të dalin fuqishëm kundër çfarëdo njohjeje të shtetit të pavarur.

Serbia vazhdon të mbajë qëndrim të njëjtë në lidhje me pavarësinë e Kosovës edhe pas opinionit të GjND-së i cili e bëri të qartë legjitimitetin e pavarësisë së Republikës së Kosovës. Edhe pse tash e sa vite pas këtij opinionin dhe një sërë lëvizjesh dhe taktikash të bëra në rrafshin ndërkombëtar dhe reciprok në mes të Kosovës dhe Serbisë, kjo e fundit vazhdon me këmbëngulje dhe me strategji të vazhdueshme të llobojë kundër pavarësisë dhe shtetit të Kosovës.

Duke u bazuar në retrospektivën dhe atë që u tha më lart, kryesisht në lidhje me tentimet, lobimet dhe punën e Serbisë në vazhdimësi kundër Republikës së Kosovës, atëherë mund të pyesim se sa Republika e Kosovës në përgjithësi dhe diplomacia e Kosovës në veçanti kanë bërë dhe sa e kanë përdorur opinionin e GjND-së në favorin e shtetit të Kosovës në rrafshin ndërkombëtar me qëllim të promovimit dhe trumbetimit të së drejtës së Kosovës në favorin e saj dhe për t'u njohur nga sa më shumë shtete të tjera? Në përgjigjen e pyetjes së parashtruar më

lart, kokulur duhet të pranojmë dhe themi se shteti i Kosovës në krye me diplomacinë e tij nuk e shfrytëzuan këtë opinion aq sa duhet dhe kjo bën një të metë të madhe dhe vështirë të riparueshme për Republikën e Kosovës.

Pas shpalljes së vendimit të GjND-së ministri i Jashtëm i Kosovës në atë kohë, Skënder Hyseni, përmes një prononcimi publik tha se opinionin ishte i qartë dhe nuk lë vend për dyshim, gjithashtu u bëri thirrje shteteve që nuk e kanë njohur ende pavarësinë e Kosovës, ta bëjnë tani pasi që GjND-ja tha fjalën e saj.

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së ka aprovuar mendimin e GjND-së në lidhje me pavarësinë e Kosovës dhe ka bërë thirrjen që Kosova dhe Serbia të angazhohen për zgjidhjen e problemit mes tyre duke u drejtuar drejt procesit integruar dhe të mbyllet mundësia që shtetësia e Republikës së Kosovës të diskutohet me këdo. Parlamenti Evropian (PE) u ka bërë thirrje vendeve të BE-së të cilat nuk e kanë njohur ende pavarësinë e Kosovës ta njohin sa më parë.

Serbia u mundua dhe synoi në të gjitha mënyrat për zhbërjen e pavarësisë së Kosovës por, nuk pati sukses, si dhe me vendimin e GjND-së Serbia i dha edhe një "vulë" fuqizuese pavarësisë së Kosovës e cila largoi çdo dyshim për këdo që dyshon në legjitimitetin e pavarësisë.

Pas vendimit të GjND-së pritej që të kishte një valë të njohjeve të reja për shtetin e Kosovës, mirëpo nuk pati rezultate aq të mëdha siç pritej. Edhe pse nuk pati njohje për shtetin e Kosovës pas vendimit të GjND-se, ashtu siç pritej, të paktën vendet që nuk e njohin Kosovën nuk mund të gjenin arsye për legjitimitetin e pavarësisë siç bënin para vendimit të GjND-së për pavarësinë e Kosovës. Dhe të gjitha këto shteti i Kosovës dhe diplomacia e Kosovës nuk i shfrytëzuan në maksimum dhe nuk i vlerësuan në vlerat e tyre reale, prandaj edhe pas shumë

viteve numri i njohjeve për shtetin e Kosovës mungon dhe është sfidë e vazhdueshme dhe lodhëse në të gjitha drejtimet për Republikën e Kosovës.

Ministria e Jashtëm e Kosovës punon në vazhdimësi duke vepruar përmes strategjive dhe mundësive të caktuara me qëllim të sjelljes të sa më shumë njohjeve për shtetin e Kosovës por që shpeshherë ka moskoordinime dhe përkrahje brendainstitucionale, si dhe ngecje të bashkëpunimeve adekuate në mes relacioneve të shërbimeve të saj, jashtë vendit dhe vete MPJ-së në lidhje me këtë drejtim. Republika e Kosovës në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë në vazhdimësi lobon për njohjen e Kosovës nga sa më shumë vende të cilat nuk e kanë njohur ende pavarësinë e Kosovës, por kjo e fundit nuk e shpërfaqë dhe argumenton në mënyrë të duhur opinionin e GjND-së përballë atyre shteteve të cilat hezitojnë që ta njohin Republikën e Kosovës si shtet.

Mendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë është menduar të ketë ndikim në sjelljen e njohjeve ndërkombëtare për Republikën e Kosovës si dhe të sjellë mundësi anëtarësimi në OKB e organizma të tjerë rajonalë, ndërkombëtarë, globalë, mirëpo nuk dha rezultate ashtu siç u pritën.

Kështu që, pas shumë vitesh të opinionit të GjND-së, Republika e Kosovës ka vazhduar që të qëndrojë në stadin e vjetër në lidhje me shfrytëzimin e kësaj poente në rrafshin ndërkombëtar përballë atyre shteteve të cilat hezitojnë dhe nuk e kanë njohur ende shtetin e Kosovës.

Shteti i Serbisë në vazhdimësi dhe pa reshtur po punon në disfavorin e Republikës së Kosovës në të gjitha drejtimet dhe aspektet. Kështu që Republika e Kosovës duhet të përballet njëkohësisht edhe me këtë ofensivë të egër të Serbisë kundër Republikës së Kosovës si dhe duhet të formulojë dhe të implementojë strategji dhe taktika fitimprurëse për interesin dhe imazhin e Republikës së Kosovës në rrafshin ndërkombëtar si dhe të punojë në veçanti për sjelljen e njohjeve të reja.

Opinionin i GjND-së duhet të shfrytëzohet në vazhdimësi nga Republika e Kosovës, pa marrë parasysh se sa vite kanë kaluar nga ky opinion, ai gjithmonë ka vlerë të shpërfaqet, kujtohet dhe trumbetohet para atyre shteteve të cilat hezitojnë apo ende nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës, si dhe për këtë çështje është e obliguar të punohet në vazhdimësi nga Republika e Kosovës dhe institucionet e saj, sidomos me theks nga diplomacia e Kosovës.

SIGMA



VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA KOSOVË

NJOFTIM PËR ZHVENDOSJE TË ZYRËS

Të nderuar klientë dhe palë të interesuara,
Ju njoftojmë se Zyra Qendrore e kompanisë së sigurimeve Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Dega Kosovë do të zhvendoset në adresën e re, që është:

• Aktash, Rr. Edmond Hoxha nr. 27 (afër udhëkryqit tek menza e studentëve), Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Data e planifikuar/propozuar dhe për zhvendosjen e zyrës qendrore është 23.12.2019.

Ne do të vazhdojmë të jemi në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar shërbimet e kompanisë tonë të sigurimeve në adresën e re të lartshënuar të Zyrës Qendrore.

Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe ju mirëpresim në zyrat e reja!

NOTICE FOR OFFICE TRANSFER

Dear clients and interested parties,
We inform you that the Head Office of insurance company Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Kosovo Branch will move to the new address, that is:

• Aktash, Edmond Hoxha Str. No. 27 (near the crossroads of the student mess canteen), Prishtina 10000, Republic of Kosova

The planned/proposed date for the Head Office transfer is 23.12.2019.

We will continue to be at your disposal to offer our insurance company's services at the above new Head Office address.

Thank you for your understanding and welcome to the new offices!

OBAVIJEST O ZAMJENI KANCELARIJE

Dragi klijenti i zainteresovane strane,
Obaveštavamo vas da će glavno sedište osiguravajućeg društva Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Filijala Kosova preseliti na novu adresu, a to je:

• Aktash, Ul. Edmond Hoxha br. 27 (blizu raskrsnice studentske menze), Priština 10000, Republika Kosova

Planirani/predložni datum preseljenja kancelarije na novu adresu glavnog sedišta je 23.12.2019.

Me ćemo i dalje biti na vašem raspolaganju da vam pružimo usluge našeg osiguravajućeg društva na gore navedenu novu adresu glavne kancelarije.

Hvala vam na razumevanju i dobrodošli u nove kancelarije!



SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. - DEGA KOSOVË

Qyteza Pejton, Rr. Ukshin Hoti Nr.13, Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel.+381 38 246 301, Fax. +381 38 246 302 www.sigma-ks.net info@sigma-ks.net



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

- Quality & Sales Award Recipients**
[Listed in alphabetical order]
- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
 - ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
 - ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
 - ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
 - ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
 - ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
 - ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
 - ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
 - ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
 - ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



Esper: ShBA-ja nuk tërhiqet nga Iraku

UASHINGTON, 7 JANAR - Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Mark Esper, tha se Shtetet e Bashkuara nuk do t'i tërheqin trupat nga Iraku. Ai sqaroi se një letër e shkruar nga një komandant amerikan në Irak, ku lihej të kup-

tohej se trupat do të tërhiqeshin, ishte një gabim. "Nuk ka vendim për t'u larguar nga Iraku dhe nuk ka ndonjë plan për këtë", tha Esper.

Letra e cila u publikua edhe në Twitter, i ishte dërguar Qeverisë

irakiane nga një komandant amerikan në Irak. Në të thuhej se "Shtetet e Bashkuara respektojnë vendimin e Irakut që kërkon largimin tonë dhe se trupat amerikane do të ripozicionohen në ditët dhe javët në vijim në për-

gatitje për lëvizjen e mëtejshme". Gjeneral Mark Milley, shefi i Shtabit të ushtrisë, u tha gazetarëve se letra ishte thjesht një draft që u ishte dërguar aleatëve në Irak, për të marrë komentet e tyre dhe për të koordinuar gjuhën.



Reagime nga bota për vrasjen e Qassem Soleimanit

Vrasja e gjeneralit të lartë të Iranit, Qassem Soleimani, ka bërë që të shpërthejnë protesta në të gjithë Lindjen e Mesme, ndërkohë që NATO-ja ka pezulluar misionin e trajnimit në Irak për shkak të shqetësimeve në rritje të një përshkallëzimi të dhunës



PRISHTINË, 7 JANAR - Aleatët evropianë të Amerikës kanë bërë thirrje për uljen e përshkallëzimit nga të gjitha palët pas premtimit të Iranit për t'u hakmarrë për vrasjen e gjeneralit të lartë të vendit nga Shtetet e Bashkuara. Qassem Soleimani u vra në një sulm me dron në aeroportin e Bagdadit të premtim. Protestat kanë shpërthyer në të gjithë Lindjen e Mesme, dhe NATO-ja ka pezulluar misionin e saj të trajnimit në Irak për shkak të shqetësimeve në rritje të një përshkallëzimi të dhunës.

Ndërsa aleatëve evropianë të Amerikës nuk iu dha paralajmërim paraprak për sulmin ndaj gjeneralit të lartë të Iranit, kryeministri britanik Boris Johnson tha se vendi i tij "nuk do të vajtonte" vdekjen e Soleimanit.

Britania, ashtu si Shtetet e Bashkuara, është ndër vendet që vuajtën nga veprimet e tij, thonë analistët. "Qassem Soleimani ka qenë përgjegjës për vdekjet e

qindra trupave amerikane dhe trupave të tjera perëndimore, përfshi ato britanike", thotë Karen von Hippel me Institutin për Shërbimet e Bashkuara Mbretërore.

Ndërsa dhjetëra-mija njerëz vajtuan në Iran, Britania, Franca dhe Gjermania lëshuan një deklaratë të përbashkët duke u bërë thirrje të gjitha palëve të "ushtrinë përmbajtje dhe përgjegjësi maksimale".

Bashkimi Evropian ka ftuar ministrin e Jashtëm të Teheranit në Bruksel në një përpjekje për t'i qetësuar tensionet. "Ekziston një mirëkuptim i ndërsjellë se angazhimi duhet të vazhdojë, por është në anën iraniane për të na njoftuar se si duan të vazhdojnë", thotë Peter Stano, zëdhënës i Komisionit Evropian.

Evropa shpreson që marrëveshja bërthamore e 2015 me Iranin mund të shpëtohet - pavarësisht njoftimit të Teheranit se tani nuk do t'i pranojë të gjitha kufizimet në aktivitetet e tij të pasurimit

bërthamor. "Nuk mendoj se marrëveshja ka vdekur derisa të ketë një përshkallëzim që çon në luftë", thotë Holly Dagres nga Këshilli i Atlantikut.

Irani ka premtuar hakmarrje ushtarake - dhe aleatët e Amerikës janë gjithashtu të shqetësuar se mund të vihen në shënjestër.

NATO-ja ka pezulluar misionin e saj të trajnimit në Irak, me disa qindra trupa - pjesë e koalicionit perëndimor për të mposhtur Shtetin Islamik.

Sekretari i Përgjithshëm i aleancës nuk pranoi të komentojë të hënën nëse aleatët e NATO-s do të mbështesin Shtetet e Bashkuara në çdo kon-

flikt me Iranin. "Ne kemi parë kohët e fundit një përshkallëzim nga Irani, duke përfshirë sulmin ndaj një objekti energjetik saudit dhe rrëzimin e një droni amerikan. Në takimin tonë sot, aleatët bënë thirrje për përmbajtje dhe uljen e tensioneve. Një konflikt i ri nuk do të ishte në interesin e askujt", tha sekretari Stoltenberg.

Rusia dhe Kina dënuan vrasjen e Soleimanit. Analistët thonë se Teherani tani mund të kërkojë mbështetje më të madhe nga aleatët e tij. "Para këtij përshkallëzimi, Kina, Rusia dhe Irani zhvilluan manovra të përbashkëta detare në Gjirin Persik dhe Gjirin e Omanit", thotë Holly Dagres nga

Këshilli i Atlantikut.


Në Lindjen e Mesme, protestat anti-amerikane janë përhapur nga Irani dhe Iraku në Turqi, territoret palestineze dhe Liban.

Protestuesit gjithashtu dolën në rrugë në Pakistan.

Ndërkohë, Izraeli, armiku i Iranit për një kohë të gjatë, vlerësoi veprimin e Shteteve të Bashkuara. "Presidenti Trump meriton të gjitha vlerësimet pasi veprimi me vendosmëri, forcë dhe shpejtësi", tha kryeministri Benjamin Netanyahu.

Të gjithë sytë janë tani tek Irani - dhe nëse ai do t'i kushtojë vëmendje thirrjeve globale për përmbajtje, ose do të përmbushë premtimin e tij për hakmarrje.

Putini viziton Sirinë



MOSKË, 7 JANAR - Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, po qëndron për vizitë në Siri ku takoi presidentin, Bashar al-Assad dhe zhvilloi konsultime me zyrtarët ushtarakë rusë në Damask.

Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, u tha gazetarëve në Moskë, se Putini udhëtoi me një automjet në rrugët e kryeqytetit sirian, nga Aeroporti Ndërkombëtar i Damaskut në selinë e grupit të Forcave të Armatosura Ruse.

Peskov tha se Putini është takuar me Asadin në selinë e Forcave të

Armatosura Ruse. "Udhëheqësit Putin dhe Asad dëgjuan së bashku raportet ushtarake për zhvillimet në rajone të ndryshme të vendit", tha Peskov.

Vizita e Putinit nuk ishte e paralajmëruar më herët.

Rusia është aleati kryesor i presidentit sirian Bashar al -Asad, forcat ushtarake të të cilit po luftojnë me rebelët që kundërshtojnë regjimin e tij.

Idlib në veriperëndim të Sirisë është rajoni i fundit i madh i mbajtur nga rebelët që kundërshtojnë presidentin Bashar al-

Asad.

Qeveria siriane e mbështetur nga Rusia e ka bombarduar Idlibin që nga fundi i nëntorit.

Më shumë se 235 000 njerëz kanë ikur nga shtëpitë e tyre në provincën Idlib të Sirisë.

Eksodi ndodhi midis 12 dhe 25 dhjetorit.

Presidenti amerikan, Donald Trump, ka paralajmëruar Rusinë, Sirinë dhe Iranin kundër vrasjeve të civilëve në provincën Idlib të Sirisë dhe ka thënë se Turqia është duke punuar shumë që të ndalë "masakrën".

Rikthehet Kurz, bën betimin si kancelar

VIENË, 7 JANAR - Konservatori Sebastian Kurz u betua të martën si kancelar i Austrisë. Ai u rikthye në detyrë, pas rrëzimit të qeverisë së tij, në muajin maj, për shkak të një skandali të korrupsionit.

Kriza politike në Austri nisi si pasojë e shfaqjes së një videoje, që supozohej se tregonte zëvendëskancelarin e atëherëshëm, Heinz-Christian Strache duke i ofruar kontrata një për-

fitueseje potenciale ruse, në këmbim të donacioneve politike. Austria është udhëhequr gjatë muajve të fundit nga një qeveri e përkohshme, të cilës i ka prirë kancelarja Brigitte Bierlein.

Kurz, 33 vjeç, është kryeministri me moshën më të re në botë. Ai arriti ta formojë shumicën për ta formuar qeverinë e re falë një koalicioni me Partinë e të Gjellbëve.



Çmimet BAFTA, “Joker” filmi me më së shumti nominime

Janë publikuarit nominimet për edicionin e 73 të Çmimeve të Akademisë Britanike të Filmit, që njihen si BAFTA, ceremonia e të cilit do të mbahet në datën 2 shkurt, në Londër. “Joker” është filmi me më shumë nominime, plot 11, ndërsa “The Irishman” dhe “Once Upon a Time in Hollywood” ndjekin me nga 10

nominime secili.

Drama “Joker” me protagonist Joaquin Phoenix dhe regjisor Todd Phillips duket se do të dominojë mbrëmjen, pasi do të konkurrojë për filmin më të mirë, regjisorin më të mirë, aktorin protagonist më të mirë, skenarin e përshtatur më të mirë, montazhin më të mirë, “make up”-in më të mirë dhe



zërin më të mirë.

Të dielën në mbrëmje, Joaquin Phoenix fitoi çmimin “Golden Globe” si aktori më i mirë për interpretimin e tij në filmin

“Joker”. Në kategorinë e aktorit më të mirë joprotagonist do të jetë një “luftë” e fortë me Al Pacino e Joe Pesci (The Irishman) dhe Tom Hanks (A

Beautiful Day in the Neighbourhood), Sir Anthony Hopkins (The Two Popes) dhe Brad Pitt (Once Upon a Time...)



“Nuk duhet t’i humbasim rastet më të mira që na shfaqen në jetë”

Nicolas Cage është aktor amerikan dhe fitues i çmimit Oskar, Cage punon edhe si regjisor dhe producent filmi të kompania prodhimit të tij Saturn Films. Nicolas Kim Coppola (i lindur më 7 janar 1964), i njohur profesionalisht si Nicolas Cage, është një aktor dhe producent amerikan.

Ai e ka kryer në rolet kryesore në një shumëllojshmëri e filmave, duke filluar nga komeditë romantike dhe drama të science fiction dhe filmat e veprimt. Në vitet e para të karrierës së tij, Cage luajti në filma të tillë si Valley Girl (1983), Racing me Moon (1984),

Birdy (1984), Peggy Sue Got mar-tuar (1986), Rritja Arizona (1987), i rrjedhur (1987), vampir s Kiss (1989), Wild në Zembrës (1990), Honeymoon në Vegas (1992), dhe Red Rock Perëndim (1993).

Cage mori një Academy Award, një Golden Globe, dhe Screen Actors Guild Award për performancën e tij si një shkrimtar alkoolike Hollivudit në Leaving Las Vegas (1995) para se të vijë në vëmendjen e shikuesve më të gjerë me filmat e zakonshme të tilla si The Rock (1996), Face / Off (1997), Con Air (1997), City of Angels (1998), dhe Treasure Kombëtare (2004).

Ai fitoi emërimin e tij të dytë Akademia Award për performancën e tij si Charlie dhe Donald Kaufman në Adaptimi (2002). Në vitin 2002, ai drejtoi filmin Sonny, për të cilat ai ishte i nominuar për Çmimin e Madh të Veçantë në Festivalin e Filmit Dovijë. Cage zotëron kompaninë e prodhimit Saturn Films dhe ka prodhuar filma të tilla si hije e Vampire (2000) dhe Jeta e David Gale (2003).

Më poshtë thënia e tij e famshme: “Nuk duhet t’i humbasim rastet më të mira që na shfaqen në jetë, thjesht ngaqë jemi të sigurtë se s’i meritojmë”.

Festivali i Filmit Evropian vjen në Prishtinë

Mes 13 – 17 janar 2020, Europe House në bashkëpunim me Kino ARMATA organizon Festivalin e Filmit Evropian në Prishtinë.

Java e filmit do të hapet me filmin kroat “Kushtetuta” dhe do të mbyllet me filmin francez “Qumështi i përgjakur”.

Hyrja për të gjithë filmat është falas. Ejani në Kino ARMATA dhe përjetoni filmat evropianë që do të shfaqen. Të gjithë filmat do të kenë përkthim në gjuhën shqipe dhe angleze.

Poshtë e gjeni orarin e filmave, me përshkrime në gjuhën angleze.

13 January 2020 / at 8pm
THE CONSTITUTION by Rajko Grlic (2016)

Countries: Croatia, Slovenia, United Kingdom, Czech Republic

Main Awards: Montréal World Film Festival award for Best Film, Raindance Film Festival award for Best Film, Best Screenplay, Best Performance

14 January 2020 / at 8pm
RAY & LIZ by Richard Billingham (2018)

Countries: United Kingdom
Main Awards: Locarno International Film Festival: Special Jury Prize, Seville European Film Festival: Grand Jury Award, British Independent Film Awards: Douglas Hickox Award



E jashtëzakonshme

Pacientja me kancer merr flakë gjatë operacionit në spital

Një paciente ka vdekur pasi u dogj gjatë operacionit në një spital në Rumani. Kirurgët në Spitalin Floreasca në Bukuresht përdorën një dezinfektues me bazë alkoolin mbi gruan 66-vjeçare përpara se ta kryenin operacionin për kancerin pankreatik më 22 dhjetor. Por më pas përdorën një bisturi elektrike, e cila, kur ra në



kontakt me alkoolin, bëri që trupi i gruas të merrte flakë në tryezën e operacionit. Ajo pësoi djegie në 40 për qind të trupit të saj dhe vdiq në spital një javë më vonë.

FOTO E DITES



Makinat e shtypura nën një shtëpi pas një tërmeti me magnitudë 5.8 në Porto Riko. /AP/

E rrallë

Harron çantën me 95 mijë euro në restorant, ia kthejnë pa i marrë asnjë cent

Pushimet e këtij dimri mund të kishin qenë ato ndër më të këqijat në jetën e një biznesmeni nga Latina. Pasi konsumoi diçka në një restorant, biznesmeni u largua për të harruar aty një çantë që përmbante rreth 95 mijë euro. Megjithatë, punonjësit e barit e pikasën dhe kontrolluan



menjëherë për ta gjetur poseduesin e tyre. Pas kontrolleve u gjet edhe pronari i saj, të cilën e lajmëruan menjëherë. Por surpriza ishte e madhe kur panë që të gjitha paratë ishin në çantë.

BARSOLETA E DITËS



Polici: Pse e vrave gruan?
Burri: Më tradhtoi.
Polici: Po gruan e dytë?
Burri: Edhe ajo më tradhtoi.
Polici: Po gruan e tretë?
Burri: M'u bë shprehi!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.

Regjia: Jake Kasdan



Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj

Regjia: J.J. Abrams




Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu




Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).



DASHI
Ditë e favorshme për kultivimin e miqësive, interesave dhe marrëdhënies me partnerin. Gjithçka po shkon mirë me partnerin tuaj!



DEMI
Sot paratë do të dalin pa ndërprerje nga xhepat tuaj. Të gjitha faturat kanë gjetur të njëjtën ditë për t'u paguar.



BINJAKËT
Tensionet familjare dhe jo vetëm me partnerin, por edhe me të afërmit do të hyjnë në lojë. Disa thashetheme do t'ju nervozojnë dhe do ju stresojnë.



GAFORRJA
Sot ju do qëndroni dhe shikoni, duke i lënë të tjerët të veprojnë në emrin tuaj. Edhe ndjenjat nuk do të shkojnë përtej miqësisë, thjesht mos krijoni iluzione.



LUANI
Në dashuri, mos kini me dyshime ose hutime, kjo është koha më e mirë për të sqaruar me partnerin tuaj. Është mënyra e duhur për të rregulluar dhe rigjallëruar marrëdhënien tuaj.



VI RGJËR ESHA
Fusha e dhjetë në astrologji simbolizon pushtet, por me shumë pauza dhe gabime. Do të arrini atje, por së pari do të zgjidhni çështjet në pritje! j.



PESHORJA
Një ditë gati perfekte. Yjet sigurojnë entuziazëm, nerva të fortë, mundësi për të dalë mirë nëse keni një aktivitet të pavarur.



AKREPI
E martë e zënë, plot këmbime, e favorizuar nga zgjidhja e disa problemeve të vjetra. Do të rizbuloni kënaqësinë për të studiuar ose mësuar përsëri diçka që keni mësuar në të kaluarën.



SHIGJETARI
Ka ditë kur gjërat nuk duan të shkojnë në drejtimin e duhur. Për këtë arsye është më mirë të armatoseni me durim dhe të vazhdoni të punoni pa u dekurajuar, gjithashtu sepse kjo atmosferë nuk do të zgjasë përgjithmonë.



BRICJAPI
Do të irritoheni shumë, por nuk ka gjithmonë një zgjidhje në ambientet e punës. Nëse punoni me shumë njerëz, përpuni të keni kujdes nga kolegët, mbronin të drejtat tuaja.



UJORI
Ditë e mrekullueshme, me shumë yje që udhëheqin lojën, duke ju bërë mjeshtër absolutë të situatës, si në publik ashtu edhe në privat. Në çift, dialogët dhe projektet do shoqërohen me shumë mirëkuptim



PESHQIT
Gjërat në familje përgjithësisht do të funksionojnë mirë, por mosmarrëveshjet nuk përjashtohen. Mbani këmbët në tokë duke u përpjekur ta bëni veten më të kapshëm për të tjerët dhe jeta juaj do të ndryshojë!

Aktori i njohur dhuron një milion dollarë për Australinë



Aktori i njohur Chris Hemsworth ka qenë një nga aktorët që ka ofruar mbështetje për luftimin e zjarreve në Australi. Përmes një postimi të bërë në rrjetin social "Instagram", ai ka bërë me dije se ka dhuruar një

milion dollarë për t'u ndihmuar zjarrfikësve dhe njerëzve që po kontribuojnë lidhur me këtë rast. "Sikurse ju, edhe unë dua ta mbështes luftën kundër zjarreve këtu në Australi", ka shkruar ai në përshkrim.



Bebe Rexha: Këtë vit do ta bëj jetën që unë dua

Këngëtarja shqiptare me famë ndërkombëtare, Bebe Rexha, ka bërë së fundmi një postim në rrjetet sociale. Në mbishkrimin e fotografive që ajo ka postuar ka thënë që këtë vit dëshiron të jetojë jetën që ajo dëshiron pa u

ndikuar prej të tjerëve. "Gjendja ime për tërë vitin. Vetëm duke qenë vetë dhe duke jetuar jetën që dua. Nuk jetoj më për të tjerët. Nëse ata më pëlqejnë për atë që jam, kjo ka vlerë për mua", ka shkruar këngëtarja.

Dua Lipa, me kamerë të fshehtë ndaj të panjohurve në një market



Këngëtarja shqiptare me famë ndërkombëtare, Dua Lipa, së fundmi ka qenë e ftuar në emisionin "Ellen DeGeneres Show". Asaj i është dhënë një mision që t'i vë në lojë

klientët e një dyqani. Ajo ka realizuar një kamerë të fshehtë për emisionin e famshëm të Ellen, ku duhet t'u pëshpëritë njerëzve të panjohur tekstin e këngëve të veta në formë bisede.

Ledri Vula habit fansat, zhduk gjithçka nga "Instagrami"



Ledri Vula është një nga reperët më të suksesshëm. Çdo këngë që ai nxjerr në treg pëlqehet dhe klikohet nga të gjithë. Gjithashtu, ai është dhe një nga personazhet publike që numëron mbi një milion ndjekës në

"Instagram". Së fundmi reperi ka marrë një vendim që habiti të gjithë. Ai ka fshirë të gjitha fotot dhe videot që ka postuar gjatë jetës dhe karrierës së tij. Nuk dihet ende arsyeja e këtij vendimi, por me siguri që Ledri ka diçka në mendje.

Një roman përtej provokimit

Shënime për romanin “Dashuritë e virgjëreshës Madalenë” të autorit Ridvan Dibra

Në vitin 1955, në shtëpitë botuese të Francës qarkullonte një dorëshkrim me përmbajtje erotike që nuk gjente vend për kohën dhe që iu mohua e drejta e botimit pa keqardhje. Shtëpia e vetme botuese që e mori për-sipër ishte një zyrë e vogël, e cila shumicën e botimeve të saj i kishte të një përmbajtjeje të fortë erotike. Kjo është historia e ardhjes së “Lolitës” të Nabokovit, libër që është konsideruar nga shumë autorë si një prej veprave më të mira letrare të shekullit XX.

Kurse sot, në vitin 2019, unë mbaj në dorë “Dashuritë e Virgjëreshës Madalenë”, shkruar nga Ridvan Dibra. Një libër me natyrë të gjallë provokuese e kontroversale. Në qendër të veprës një personazh me emrin Madalenë dhe që shoqet e thërrasin shkurt Lena. Një Lenë që e shohim tek rritet nëpër tri fazat më kryesore të jetës së saj:

moshat 15, 25 e 40 vjeç.

Në vitin e saj të 15-të takojmë një vajzë të brishtë, të ndikuar nga shoqëria dhe që as nuk e imagjinonte sa vendimtare do ishte kjo fazë në të gjithë jetën e saj. Këtu Dibra luan me pasigurinë e moshës, me egon adoleshente dhe me një anë psikologjike që të përball me shumë kurthe. Nis tjetërsimi e absurdi i realitetit, që e çon Lenën drejt një barre ekzistenciale. Në vitin e 25-të kemi një Lenë të hareshme, që besonte te dashuria, në atë të vërtetën ama, por dashuria nuk besoi tek ajo. Në këtë pjesë trajtohet raporti dashuri-mentalitet, frustrimi i një shoqërie të prapambetur që vazhdon të ndikojë te personazhi kryesor. Dibra vazhdon zbërthimin e psikologjisë së gruas dhe nxjerr në pah dramën e saj, duke luajtur edhe më shumë me mendimet e lexuesit. Kurse në vitin e 40-të njihemi



me Madalenën, zonjën e vërtetë e të realizuar në të gjitha aspektet, por akoma jo nga dashuria! Në këtë fazë ironia luan rolin e kontradiktës. Është vetë Madalena që dëshmohe kundër unit të saj dhe kështu na paraqitet si një grua të cilën e plotësoi vetë absurdi i jetës. Ridvan Dibra shtron një akt që na vjen si një vetëdije e lidhur drejtpërdrejt me realitetin. Ky autor gjuhën e zotëron me fleksibilitet të plotë, ku stili post-modern përzihet me metaforën erotike për të na dhënë pohime që kanë brenda kontrastin, absurdin. Vërehet se shpeshherë ligjërimi ka gjurmë vulgariteti, gjë që nuk vjen si rastësi, por lidhet me metaforën bazë të romanit. Struktura gjuhësore e përdorur është dinamike dhe e shtyn lexuesin drejt familjarizimit me dimensione të reja. Kjo strukturë e pasqyron denjësisht botën si objekt të veprës, duke gjeneruar më tej kuptimet mbi realitetin.

Karakteristikat postmoderne në këtë vepër lëvizin si në strukturën e brendshme të saj, ashtu edhe në detajet e ndërtimit të jashtëm, duke na treguar një anë spontane ku raporti mimetik i realitetit shfaqet i lirë dhe i natyrshëm. Duket sikur Dibra

eksperimenton me një tematikë tabu, por edhe me vetë strukturën e romanit, duke na ndër-futur në një pafundësi qasjesh e mendimesh. Nisur nga konceptimi i strukturës së romanit, shihen disa qëndrime të veçanta e të pazakonta. Prologu në këtë vepër merr një qëndrim krejt ndryshe. Fillimisht, ndërton një formë dialogu paralajmërues me lexuesin. Në vazhdim është në kërkim të një lexuesi ndryshe, një lexuesi që e mban peshën e kuptimit të kësaj veprë. Dibra rrëfimtari njëjtësohet me heroinën e veprës, duke na sfiduar ne si lexues dhe duke thyer kufijtë ekzistentë mes reales e trillit.

Loja letrare na befason: personazhi kryesor bëhet autor i parë dhe vetë autori kthehet në personazh, duke thyer formën tradicionale e duke maskuar kufijtë e një veprë të vërtetë artistike. Nihilizmi shfaqet në dy forma: nëpërmjet neverisë që autori-personazhi ndien ndaj absurdit dhe me anë të raportit të krijuar mes realitetit e “banalitetit” që shpesh e mbi-zotëron ligjërimin letrar. Kombinime të ndryshme brenda një strukture, kalime të papritura nga një periudhë kohore në tjetrën dhe shpërthimet e spektrit seksual e bëjnë këtë vepër të

jetë një novacion i letërsisë moderne. Dibra na dhuron një vepër ku kufijtë kohorë e hapësinorë shkrihen, një vepër të mirëfilltë që trajton shoqërinë dhe shuplakat që kjo e fundit hedh pafund drejt gjithsecilit nga ne. Mos vallë Virgjëresha Madalenë është vetë Dibra, apo jemi të gjitha ne, vajzat dhe gratë e shekullit të ri?! Gjatë leximeve të mia kam hasur shumë shkrimtarë që e kanë portretizuar figurën e femrës, por të paktë kanë qenë ata që na e kanë servur me kaq mjeshtëri psikologjinë e saj, pasigurinë dhe ndjeshmërinë. Nuk do mend, po flas për një shkrimtar që e përdor me aq fleksibilitet metaforën erotike, sa që lexuesi vallëzon me fjalën dhe ndjesinë e dhuruar. “Dashuritë e Virgjëreshës Madalenë” është një trill letrar që të has njëkohësisht me provokimin, por edhe me hezitimin. Një vepër që tenton t'i shkojë deri në palcë shoqërisë shqiptare dhe jo vetëm, duke trajtuar një temë që “fshihet” në skutat më të errëta të njeriut. Kjo vepër vjen si një vullkan i vërtetë social e letrar, që ia vlen të rindizet herë pas here nga lexues të vërtetë.

Exlibris/Alba KALLOGJERI, studente në gazetari

RIDVAN DIBRA

*Dashuritë
e virgjëreshës
Madalenë*



OnufriRoman

Kërkohet logoja më e pëlqyer për 100-vjetorin e Tiranës kryeqytet

Kryetari i Bashkisë së Tiranës Erion Veliaj fton të gjithë ata që kanë talent dhe pasion për të dërguar brenda kësaj jave logon për këtë përvjetor duke krijuar diçka të bukur për historinë e këtij qyteti.

Ky vit shënon edhe 100-vjetorin e shpalljes së Tiranës si kryeqyteti i Shqipërisë. Kryetari i Bashkisë së Tiranës Erion Veliaj fton të gjithë ata që kanë talent dhe pasion për të dërguar bren-

da kësaj jave logon për këtë përvjetor duke krijuar diçka të bukur për historinë e këtij qyteti.

“Java e fundit për dërgimin e logos për 100-vjetorin e Tiranës KRYEQYTET . Mirëpresim punimin tënd deri më 12 janar, ora 17:00 me email në 100@tirana.al! Ke talent dhe dëshirë për të bërë diçka të bukur për historinë e qytetit tënd? Kjo është mundësia jote.

Krijo logon e 100 vjetorit të Tiranës kryeqytet!”, shkruan Veliaj.

Më 11 shkurt të vitit 1920 qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjes u vendos në Tiranë, duke e shpallur kështu zyrtarisht kryeqytet i vendit. Në këtë datë vlerësohet historikisht ardhja e qeverisë shqiptare në Tiranë me në krye Sulejman bej Delvinën dhe pritja iu bë asaj nga populli tiranas. /Shqiptarja



Njeriu që shpiku shitblerjen e librave siç është edhe sot – “Tempulli i Muzave” i James Lackington-it, libraria më e lirë në botë

Nga John PIPKIN

Pak njerëz ka të ngjarë ta kujtojnë sot James Lackington-in (1746–1815) dhe librarinë e tij dikur të famshme në Londër, “Tempulli i Muzës”, por nëse ka të ngjarë që si klient të keni blerë ndonjëherë një libër me çmim shumë të lirë, keni përshkuar mendueshëm rreshtat e rafteve të mbingarkuara të një librerie të madhe, ose keni kaluar një pasdite në zonën e leximit të një librerie thejst për qejf (pa blerë asgjë!), atëherë i keni përjetuar tashmë disa nga mënyrat me të cilat Lackington-i ndryshoi skajshmërisht shitblerjen e librave në fund të shekullit të 18-të.

Dhe nëse jeni shitës librash, atëherë ka gjasë që t'i keni hasur tashmë strategjitë e marketingut dhe trysninë e konkurrencës që e ka zanafillën në dyqanin e librave të Lackington-it. Në tregun e shekullit të 21-të, ngjallet nganjëherë dëshira për një epokë më të hershme, më të thjeshtë, por tensioni i ankthshëm mes të mëdhenjve të shitblerjes dhe shitësve me pakicë duket se ka qenë i përhershëm që nga fillimi. “Tempulli i Muzës”, një nga libraritë e para moderne, ishte një sipërmarrje gjigande, deri tani libraria më e madhe në Angli, me inventar prej mbi 500.000 vëllimesh, shitje vjetore të 100.000 librave, dhe të ardhura vjetore 5.000 paund (afërsisht vlera e 700.000 dollarëve sot). Të gjitha këto e bënë Lackington-in shumë të pasur, të admiruar nga disa dhe të përbuzur nga të tjerë, por libraritësi më i madh në Londër e nisi karrierën pa lavdi, si një këpucar i pashkollë.

James Lackington

Duke qenë pjesëtar i një familjeje me 11 fëmijë, djaloshi Lackington shkoi tek një këpucar për të mësuar zanatin. Nuk kishte arsimin zyrtar, por që në moshë të hershme kuptoi vlerën e librave, dhe bashkë me shokët viheshin në kërkim të tregjeve ku shiteshin botime me çmim të lirë të poezive, dramave, dhe të letërsisë klasike të përkthyer, me qëllim që të mësonin në mënyrë autodidakte të lexuarit dhe të zgjerimit njohurisë për botën. Më vonë, u zhvendos si këpucar në Londër me bashkëshorten, Nancy-n, dhe vite më vonë përshkroi në kujtimet e tij se si me të mbërritur në qytet, e harxhoi një gjysmë korone të mbetur për të blerë librin me poezi, “Mendimet e natës” të Edward

Young: “Sepse po të blija ushqime për darkën që do ta hanim të nesërmen, kënaqësia e saj do të harrohej shpejt, por nëse do të jetonim edhe pesëdhjetë vjet të tjera, duhej të kishim “Mendimet e natës” për t'i shijuar edhe atëherë.” Jo shumë kohë më pas, në vitin 1774, Lackington-i mundi të merrte me qira një dyqan dhe filloi të shiste edhe këpucë edhe libra.

Fundi i shekullit të 18-të ishte kohë e ndryshimeve të mëdha shoqërore për Londrën. Më shumë njerëz po mësonin të lexonin, dhe shtimi i kohës së lirë për klasën punëtore dhe të mesme do të thoshte rritje e kërkesës për libra. Por librat ishin akoma artikull i shtrenjtë luksi, kurse libraritë mund të ishin vende ku ndjehesh në siklet.

Në atë kohë, nuk nxitej thjeshtë të kalaurit e kohës në librari apo qoftë edhe shfletimi i librave. Lackington-i donte të gjente një mënyrë për t'i bërë librat më të përballueshëm financiarisht dhe libraritë hapësira që vizitoheshin, duke qenë sërish aktivitete me fitim, dhe me këtë në mendje, ai filloi të ndryshoj skajshmërisht tregtinë e librave në të paktën katër mënyra. Risia e parë ishte zhdukja e elementit kryesor të jetës tregtare të shekullit të 18-të: pagesës me listë. Ai drejtoi një biznes ku paguhej vetëm me para në dorë, gjë që fillimisht i tronditi rivalët e tij dhe u quajt fyerje prej disa klientëve, por ai arsyetoi që nëse shiste me para në dorë, po kështu mund të blinte me para në dorë në vend që të merrte hua të kushtueshme. Në këtë mënyrë shmange tarifën e interesit si dhe humbjet nga klientët që nuk paguanin dot borxhet.

Risia e tij e dytë kishte të bënte me menaxhimin e librave të pashitur. Ishte praktikë standarde që shitësit e librave blinin sasi të mëdha librash, i shkateronin më pas më shumë se tre të katërtat e tyre për të rritur kështu çmimet. Por



Lackington-i bleu sasi shumë të mëdha, ndonjëherë biblioteka të tëra, dhe pastaj uli në mënyrë drastike çmimet e të gjithë librave në mënyrë që t'i shiste në sasi të mëdha. Në këtë mënyrë i mbante në qarkullim, i bënte të përballueshme financiarisht për një gamë më të gjerë blerësish, dhe në të njëjtën kohë kishte të ardhura të mëdha. Risia e tretë e Lackington-it është e njohur për këdo që i pëlqen të bëjë pazar: ai i bindi klientët që tashmë kishin një ofertë mëse të leverdisshme dhe nuk pranoi të debatohej për çmimet. Vendosi në dyqan këtë tabelë: Çdo libër ka çmimin më të ulët dhe nuk ka ulje çmimi për asnjë artikull. Deri në 1794, ai kishte grumbulluar sasi kaq të madhe librash sa vendosi që bashkë me ortakun Robert Allen të zhvendosej në një librari në “Finsbury Square”. E quajti librarinë “Tempulli i Muzave” dhe sipër hyrjes vendosi një tabelë ku me guxim lajmëronte: Libraria më e lirë në botë. “Tempulli i Muzave” u bë një vend tërheqës për turistët dhe kjo ishte risia e

katërt e Lackington-it: madhësia e pazakontë e librarisë, me pamje spektakolare që i bënte të dukeshin të vogla të gjitha libraritë e tjera të kohës, duke u kthyer në një destinacion në vetvete.

Me një hyrje 42 metra të gjatë, në mes të hollitë të madh ishte një banak rrethor me aq hapësirë sa mund të kalonte një karrocë postare me gjashtë kuaj. Mbi këtë banak, një shkallë të çonte tek “dhomat e leximit” ku klientët mund të lexonin poshtë galerive me raftet e mbushura me libra në plot katër kate. Kat pas kati, klientët gjenin libra më të përdorur dhe më të lirë. Poeti John Keats kaloi shumë orë duke lexuar falas në “dhomat e leximit” dhe pikërisht atje u takua me botuesin e tij të parë, “Taylor and Hessy” të cilët punonin në dyqan.

Siç ishte e zakonshme në atë kohë, shumë shitës librash ishin gjithashtu edhe botues, dhe Lackington-i herë pas here bëhej pjesë e sipërmarrje të tjera botuese. Më e rëndësishmja, në 1818, Lackington-i u bashkua me Hughes, Harding, Mavor & Jones për të botuar një numër shumë të vogël (500 kopje të pamjaftueshme!) të një romani të pazakontë nga një shkrimtar i panjohur, Mary Shelley. Romani, natyrisht, ishte “Frankeshtajni”. Ndërsa një shitës librash u kthye botues, Lackington-i botoi dhe ribotoi shumë herë autobiografinë e tij, deri diku sepse ishte mëse i vetëdijshëm që emri i mirë kishte në rrezik t'i cënohej, pasi suksesi i tij ngjalli kritika nga

shitësit e tjerë të librave. Disa nga kundërshtarët argumentonin se katalogët e librave e tepronin me cilësinë e librave, kurse të tjerë këmbëngulnin se pasurinë duhej ta kishte vënë nga ndonjë llotari e fituar sepse duke e pamundur që ta kishte krijuar vetëm nga shitjet e librave. Të tjerë e akuzuan për konkurrencë të pandershme; ata thonin se ai kontrollonte një pjesë të madhe të tregut dhe duhet të “tërhiqej” nga tregu, pasi e kishte krijuar tashmë pasurinë e vet. Një argument i ngjashëm mund të dëgjohet edhe sot; tani që “Amazon” ka filluar hapjen e librarive të konceptuara si godina të ndërtuata me tulla dhe laç (e para u hap në Seattle në nëntor 2015, një tjetër në San Diego) disa kanë shtuar pyetjen nëse kjo është e nevojshme apo gjë e mirë, pasi shitësi on-line tashmë kontrollon më shumë se 60 përqind të tregut të librave.

Dhe ashtu si Jeff Bezos-i i Amazon, edhe Lackington-i u bë shumë popullor. Një flamur ngrihej sipër “Tempulli i Muzave” për të njoftuar klientët kur ishte i pranishëm në librari, kurse përshkonte rrugët e Londrës në një karrocë që kishte të shkruar me moton e tij: “Fitimet e vogla bëjnë gjëra të mëdha.” Ai madje krijoi emblema me imazhin e vet, të cilat mund të përdorshin si kompensim për pagesën e blerjeve në dyqan. Katalogu i librave që gjendeshin në librari shtypej rregullisht, dhe bëheshin porosi nga klientët të largët deri në Amerikë. Lackington-i përfundimisht ia shiti librarinë kushëritit të tretë në vitin 1798 dhe u tërhoq në fshat për t'u aktivizuar me kohë të pjesshme si predikues i Kishës Metodiste. Mjerisht, “Tempulli i Muzave” u shkrumbua nga zjarri në vitin 1841 dhe nuk u rindërtua kurrë. Megjithatë libraria gjigande nuk ishte pjesë e një zinxhiri librarish, ky zinxhir modern librarish do të krijohet vetëm një dekadë më vonë kur “A&P Supermarket” hapi dyert e saj në Amerikë ndërsa risitë e Lackington-it dhe praktika e tij e diskutueshme për të shmangur konkurrencën duke shitur me sasi të mëdha dhe me çmime shumë të ulëta, vazhdojnë të jenë pjesë e modelit të biznesit për zinxhirët e librarive të mëdha dhe shitësit në internet si Barnes & Noble dhe Amazon edhe sot.

Exlibris/Përktheu Granit ZELA
Shkrimi botuar në revistën
letrare LitHub



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Karaqi: Nuk e braktisa Kosovën, por Federatën e Karatesë

Akuzat e karateistit Alvin Karaqi në drejtim të udhëheqësve të Federatës së Karatesë së Kosovës kanë qenë të shumta. Ai ka thënë se nuk e ka braktisur Kosovën, por vetëm FKK-në dhe tash e tutje do të garojë për Shqipërinë. "Nuk e kam braktisur Kosovën, por Federatën e Karatesë së Kosovës dhe iu kam bashkangjitur Federatës Shqiptare të Karatesë, aty ku nuk përbuzem për shkaqe të kota", ka thënë Karaqi

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 7 JANAR - Alvin Karaqi është në mesin e tre karateistëve që ditë më parë morën vendim të mos e përfaqësojë më Kosovën, por Shqipërinë. Akuzat nuk kanë munguar nga tre karateistë në drejtim të Federatës së Karatesë, por edhe drejtuesit e kësaj federate nuk kanë hezitur që t'i akuzojnë Alvin Krajin, Orges Arifin dhe Blodin Pakashticën. Sikurse të mos mjaftonte e gjithë kjo, Karaqi të martën nëpërmjet një postimi të gjatë në profilin e vet në "Facebook" ka thënë se ai nuk e braktisi Kosovën, por vetëm Federatën e Karatesë së Kosovës. "Nuk e kam braktisur Kosovën, por Federatën e Karatesë së Kosovës dhe iu kam bashkangjitur Federatës Shqiptare të Karatesë, aty ku nuk përbuzem për shkaqe të kota", ka thënë fillimisht Karaqi, i cili më pas i ka demantuar drejtuesit e FKK-së se ai ka marrë pjesë në të gjitha garat. "Nga cikli olimpiq shtator 2018 e deri tani nuk jam dërguar në këto gara: PL Karate1 - Madrid 2019, PL Karate1 - Moscow 2019, Karate1 - Tokyo 2019*, Serie A Karate1 - Santiago 2019*, PL Karate1 - Shanghai 2019, PL Karate1 - Rabat 2019, Serie A Karate1 - Salzburg 2019*, Serie A Karate1 - Santiago 2018. Për hir të korrektësisë, nuk përmendet Seria A - Montreal 2019 (për shkak se ishte një javë para Lojërave Evropiane në Minsk)", ka shtuar ai. Karaqi më pas tregoi se selektori Isak Curri e largoi nga reprezentacioni i Kosovës pasi e kishte zgjedhur trajnerin Shqipe Zogiani për trajner në Lojërat Evropiane. Karateisti në fjalë vendosi për Zogianin, pasi trajneri i parë i zgjedhur Fehmi Mahalla nuk ishte i akredituar. "Më është premtuar mbrojtje nga KOK-u për këto padrejtësi, por asnjëherë nuk u realizua", ka shtuar Karaqi.

Karateisti Karaqi më pas ka zbuluar se është ofenduar dhe nënvlerësuar në vazhdimësi nga udhëheqësit e FKK-së. Një tjetër arsye për mosmarrëveshjet e Alvin Karaqit me drejtuesit e federatës është edhe borxhi njëvjeçar për biletën Madrid - Prishtinë gjatë botërorit 2018. Kryetari aktual i Federatës, Ismet Krasniqi, e ka



akuzuar Karaqin se në vitin 2016 ka paralajmëruar se nëse nuk zgjidhet kryetar Fadil Arifi, atëherë do të garojë për Shqipërinë. Lidhur me këtë akuzë, Karaqi deklaroi: "Me gjithë respektin dhe mbështetjen që kam për ju personalisht kryetar i nderuar, po i citoj fjalët që i kam thënë: 'Mos na bëni me dalë për Shqipërinë'. Asnjëherë nuk e di që të kam akuzuar ty për diçka, por sigurisht që u dal në mbrojtje dëshimeve morale dhe profesionale të ekipit tuaj".

Karaqi, po ashtu, ka hedhur poshtë edhe akuzat se kanë qenë të papërgatitur në gara, duke thënë se si student i mjekësisë, edhe përkundër obligimeve të shumta, gjithmonë ka qenë në formë të mirë fizike. Karaqi ka thënë se rezultatet nuk i kanë munguar, por largimin nga Kosova e bëri për shkak të mosrezultateve të

drejtuesve të FKK-së. "Zotërinj, a e quani mungesë rezultati që pas lëndimit arrita të kualifikohem për herë të dytë në Lojërat Evropiane? Medalje në Top 8, medalist në kampionat të Francës, medalist në Premierë Ligë, medalist në botëror të universiteteve, garues që respektohet nga kampionë dhe garues që i mposhtë ata. Me të vërtetë më ka shtyrë mungesa e rezultateve, e atyre që nuk ma dhanë mundësinë as t'u afrohem", ka deklaruar Karaqi, i cili ka treguar se gjithmonë kur ka arritur fitore e ka bërë me meritë të plotë dhe ato suksese i ka ndarë me të tjerët, derisa pas humbjeve e ka ulur kokën dhe i është përveshur punës. Në fund Karaqi e falënderoi Federatën Shqiptare të Karatesë që e rripranoi dhe ia hapi krahët sikurse në vitin 2013.

SHKURT

Llapi prezanton Atdhe Grajqevcin

Skuadra e Llapit e ka bërë zyrtare transferimin e mesfushorit Atdhe Grajqevci i cili ka nënshkruar kontratë trevjeçare me skuadrën nga Podujeva. "Mesfushori i qendrës i bashkohet vargut të futbollistëve premtues për të ardhmen e klubit. Ai ka nënshkruar kontratë trevjeçare me Llapin. Mesfushori 21-vjeçar vjen nga Drenica", thuhet në njoftimin e Llapit. 21-vjeçari ka qenë pjesë e Prishtinës, KEK-ut, së fundmi Drenicës. Po ashtu, ka mbrojtur me sukses ngjyrat e Përfaqësueses së Kosovës në kategoritë e reja.

Hasanaj largohet nga Drita, shkon te Flamurtari

Futbollisti Donat Hasanaj është larguar nga skuadra e Dritës së Gjilanit. Ai me marrëveshje të dyanshme e ka ndërprerë marrëveshjen me këtë klub, kurse nuk ka humbur kohë dhe ka filluar përgatitjet me skuadrën e Flamurtarit. Hasanaj në të kaluarën është paraqitur edhe për Prishtinën.

Plaku synon titullin me Gjilanin

Sulmuesi Sebino Plaku ka folur për herë të parë si lojtar i skuadrës së Gjilanit. Ai bëri me dije se e zgjodhi këtë skuadër pasi i përshtatet stilit të tij. "Zgjedhja e Gjilanit ishte për disa arsye dhe sa herë që kam parë Gjilanin të luante, mendoja se do të përshtateshim më së miri me njëritjetrin. Me Gjilanin kemi ambicie të njëjta, për ta marrë maksimumin e situatës dhe kjo na bën të përputhemi më së miri", ka thënë Plaku. Sulmuesi nga Tirana pati edhe disa fjalë për tifozët kuq e bardhë, duke thënë se është motiv i madh të luash para tyre. "Për tifozët e kam ndier si kundërshtar që është tifozeri e ndjeshme dhe e zjarrtë. mendoj se është fat për çdo ekip ta ketë përkrahjen e tifozëve, sepse është motiv i shtuar për cilindo nga ne. Uroj në fund të festojmë bashkë dhe t'i kalojmë këto momente, si historike", ka deklaruar Plaku.

Muriqi: Ëndërroj të punoj me Mourinhon

Vedat Muriqi po kalon një formë të shkëlqyer këtë sezon teksa është kthyer në një nga lojtarët më të mirë të Fenerbahçes, por edhe të përfaqësuesja e Kosovës. Për shkak të formës së shkëlqyer që po kalon, në drejtim të tij kanë ardhur edhe interesime nga skuadra të mëdha dhe një nga to është edhe Tottenhami. Pikërisht ky i fundit e ndjekë me kujdes sulmuesin kosovar, për të cilin mund të nisë edhe një ofertë në të ardhmen. Këtë e ka konfirmuar edhe vetë Muriqi, i e ka pranuar interesimin e Spursit dhe është shprehur se dëshiron të luajë nën urdhrat e Murinjos: "Synimi im për këtë sezon është ta fitoj titullin me Fenerbahçen. Është një ndjenjë e veçantë të jesh nën shënjestrën e klubeve të mëdha. Këto oferta, sidomos ajo e Tottenhamit, më bëjnë mua shumë të lumtur. Do të doja të punoja shumë me Mourinhon, por në fillim dëshiroj të dal kampion me Fenerbahçen. I kam lënë të gjitha ofertat për në fund të sezonit", u shpreh Muriqi.

Peja përballet me Ibër Rozhajën

PEJË, 7 JANAR - KB Peja sonte (e mërkurë) do ta zhvillojë ndeshjen e parë në këtë vit. Pejanët do të përballet me Ibër Rozhajën në Ligën Ballkanike në Palestrën

"Karagaçi" nga ora 19:00. Kjo është një ndeshje shumë e rëndësishme për skuadrën pejane, që në këtë edicion të BIBL ka dy fitore dhe tri humbje, kurse skuadra nga

Mali i Zi ka tri fitore dhe një humbje. Skuadra e Pejës ka bërë disa përforsime për stinorin pranveror ku transferimi kryesor është Dardan Berisha, kurse synimet e

kësaj skuadre janë të mëdha. "Verdhezinjtë" janë rikthyer këtë edicion si në BIBL, ashtu edhe në garat e Superligës për të synuar të rikthehen si më parë.



Grezda prezantohet tek Osijeku: Kisha oferta edhe nga Hajduku dhe Rijeka

OSIJEK, 7 JANAR - Eros Grezda është rikthyer sërish në skuadrën e NK Osijek. Futbollisti shqiptar është prezantuar sot në skuadrën kroate, kurse në këtë mënyrë e mbyllë aventurën jo të suksesshme me scokezët e Rangersit. Pavarësisht cilësive të mëdha, Grezda nuk arriti të dëshmohej në skuadrën që drejtohet nga Stiven Gerrard dhe në këtë mënyrë vendosi të rikthehet sërish në Kroaci aty ku shënoi ngritjen e madhe si futbollist. "Kam pasur disa oferta nga jashtë, por edhe nga Kroacia. Po, pati oferta edhe nga konkurrentë nga Kroacia. Më kërkuan nga Hajduku dhe Rijeka", ka thënë Grezda. Ndërkohë që drejtori i Osijekut, Alen Petroviq, ka zbuluar pak më tepër rreth formulës së marrjes së Grezdes nga Rangersi. "Rangers do të marrë një përqindje të transferimit të ardhshëm. Financiarisht, është një punë e shkëlqyeshme dhe besoj se Grezda do ta ndërmarë një hap më tej dhe do ta shesë veten në një ekip tjetër të madh.



Sidoqoftë, ne jemi të interesuar që në këtë moment vetëm ta përshtatim sa më shumë me ekipin", ka deklaruar Petroviq. Ndërsa lidhur me largimin nga Rangers, Grezda ka deklaruar: "Ndonjëherë në jetë gjërat nuk shkojnë ashtu siç i duam. Por

gjëja më e rëndësishme është që asnjëherë nuk duhet të heqësh dorë nga ëndrrat e tua. Ua uroj më të mirat shokëve të skuadrës dhe klubit", shkruan Grezda, por duke harruar që në fund të fundit gjithkush merr atë që meriton dhe korr frytet e punës.

Milwaukee humbet ndaj San Antonios

SAN ANTONIO, 7 JANAR - Skuadra e San Antonios ka triumfuar 126-104 ndaj Milwaukee, një rezultat disi surprizë, teksa është ndalur ekipi më i mirë në NBA. Spursat dominuan në ndeshje dhe e merituan fitoren, me DeRozan që realizoi 25 pikë, mbështetur edhe nga Millsi me 21 pikë. Për Bucksin u dallua Antetokounmpo, që realizoi 24 pikë e 12 rebounde, por që mbetën për statistikë. Fitore ka shënuar edhe ekipi i Sacramentos, që mposhti me rezultat 111-98 nënkampionët e



Golden State, me Hield dhe Fox që realizuan nga 21 pikë. Denveri vijon të qëndrojë në grupin e ekipeve elitë në Konferencën e Perëndimit, duke fituar me rezultat 123-115 ndaj Atlantias. Ndeshje e jashtëzakonshme për Nikola Jokiqin, që realizoi 47 pikë, i papërmbajtshëm në parket. Ekipi i Dallasit,

falë një "triple double" të Luka Donqiqit (38 pikë, 11 rebounde e 10 asistime), mposhti me rezultat 118-110 Chicagon. Fitore të vështirë korri skuadra e Washingtonit, që mundi 99-94 Bostonin (Smith 27 pikë), ndërsa Philadelphia triumfoi 120-113 ndaj Oklahomas (Richardsoni 23 pikë).

SHKURT

Rabiot: Do të qëndroj në Juventus

Adrien Rabiot i ka mohuar lajmet se do të largohet nga Juventus gjatë këtij muaji për të kaluar në Manchester United. Francezi ende s'ka arritur ta fitojë një vend në formacionin e parë të Maurizio Sarrit dhe kjo gjë bëri që të shtoheshin spekulimet për një transferim në Manchester United. "Po, unë do të qëndroj në Juventus, s'kam asnjë dyshim. Nuk kemi asnjë problem", ka thënë Rabiot. "Unë e ndiej se e kam besimin e klubit dhe të trajnerit Sarri. Viti 2019 nuk ishte i lehtë për mua. Erdha në Juventus pasi nuk pata mundësi të luaja për një kohë të gjatë. Po tentoj të përshtatem me ligën e re", ka shtuar Rabioti.

Liverpooli arrin marrëveshje me Niken, thyen rekordin e Unitedit

Liverpooli ka konfirmuar se ka rënë dakord për një marrëveshje shumëvjeçare sponsorizimi me firmën e njohur Nike, që do të hyjë në fuqi nga sezoni i ardhshëm me vlerën rekord prej 80 milionë paundësh në vit. Partneriteti i tyre me markën amerikane të sportit dhe këpucëve do të fillojë më 1 qershor 2020. Nike do të furnizojë me uniforma ekipin e parë, atë të femrave, skuadrat e akademisë, stafin e stërvitjes dhe Liverpool FC Foundation. Marrëveshja e Liverpoolit me Nike i jep mundësi The Reds të thyejë rekordin e klubeve të Premierë Ligës që mbahej nga Manchester Unitedi nga marrëveshja me Adidas (75 milionë paundë në vit). Real Madridi (98 milionë paundë) dhe Barcelona (100 milionë paundë) janë skuadrat e vetme të futbollit evropian që do të fitojnë më shumë se Liverpooli përmes sponsorizimit të uniformave. Sponsorët aktualë të "New Balance", që kanë furnizuar me uniforma "The Reds" që nga viti 2015, bënë të pamundurën për ta ruajtur partneritetin e tyre me Liverpoolin, por klubi ka vendosur t'i ndërpresë lidhjet me kompaninë me bazë në Boston.

City interesohet për Skrinianin

Skuadra e Manchester Cityt ka rritur interesimin për qendërmbrojtësin e Interit, Milan Skrinianin. Drejtuesit e skuadrës angleze raportohet se janë duke punuar që ta sjellin Skrinianin në Angli, që në afatin kalimtar të janarit. Kampionët anglezë janë në kërkim të përforsimeve të reja në mbrojtje, pasi që vitin e kaluar kishin probleme shumë të mëdha me të dëmtuarit si Laporte që nuk ishte në gjendje t'i ndihmojë fare skuadrës. Barcelona dhe Real Madridi janë dy skuadrat e tjera që janë të interesuara për 24-vjeçarin, i cili është duke kaluar në një formë të lartë tek ekipi i Interit.

Pensionohet De Rossi, do të bëhet trajner

Ish-mesfushori i Romës, Daniele De Rossi dhe përfaqësueses italiane, shpjegoi në një konferencë për shtyp edhe motivet që e çuan në largim, ndërsa falënderoi dhe klubin e fundit, fanellën e të cilit e veshi me krenari. "Është një ditë e trishtueshme për mua pasi do të doja të luaja edhe 10 vjet të tjerë, por ky është vendim përfundimtar. Nuk kam pasur probleme fizike apo të një natyre tjetër, por dua të afrohem me familjen time. Nuk kam pasur asnjë divergjencë te Boca, madje nuk mendoja se do të doja një ekip kaq shumë pas Romës. Kam pasur fatin të luaj me futbollistë më të mirë në botë", ka thënë De Rossi. Ish-kapiteni i Romës largohet nga Boca pas vetëm 5 muajsh dhe premtos se e ardhmja e tij do të jetë në bankinë. "Do të vazhdoj të punoj në futboll, por nuk e di ende se çfarë roli do të kem në mënyrë specifike. Fati im është i shënuar. Do të bëhem trajner dhe për këtë do të studioj shumë", ka shtuar ai. Ditët e fundit është përfolur se Daniele De Rossi do të jetë në hierarkinë drejtuese të Romës, me kalimin e aksioneve të pronarët e rinj.

REZULTATET

Charlotte - Indiana	104-115
Orlando - Brooklyn	101-89
Philadelphia - Oklahoma	120-113
Washington - Boston	99-94
Atlanta - Denver	115-123
New Orleans - Utah Jazz	126-128
Dallas - Chicago	118-110
San Antonio - Milwaukee	126-104
Sacramento - Golden State	111-98



Autor: GAZMEND MORINA		PENGESË A VËSHITËRËSI E PAPRITUR, QË NA DEL PËRPARA	FORMIMI I PËRGJITHSHËM E I VEÇANTË I NJERIUT	POLITIKANI SHQIPTAR EDI	IRISH FOOTBALL ASSOCIATION	DEGË E GJUHËSISË, QË STUDION MJETET TINGULLORE TË NJË GJUHE	KËNGËTARJA ... KOÇI	RENS ISTVUD	ZANORE	EPOKA E RE	EMËR I VJETËR PËR VIETNAMIN	DAMAR I GJAKUT
	PJESË ANËSORE RRETH E RROTULL DIÇKAJE									ADRIAN KRASNIQI FUSHA KU ZHVILLOHET NJË PËRLESHJE		
	TËRËSIA E GJALLESAVE NË TOKË								NJËRA NGA SIPËRFAQET KUFIZUESE TË NJË SENDI KRIJIM I ANIMACIONI			
	SHTET NË EVROPË (pashq.)							ZEZAK ISH MAFIOZI .. KAPONE				
	U ARRATISA				ZANORE DY BASHKË- TINGËLLORE		PAGJAKËSI ZBRITJE E AVIONIT NË TOKË					
	MINUS (Mat.)			DIKTATOR RUS RAFT							BASHKËT. TRUP QIELLOR QË RROTULLOH- ET RRETH NJË PLANETI (sh.shq.)	
	E ÇMPREH							VËLLIMI, SASIA KUSARI				
	TITULL I DIKURSHËM I PERANDORIT OSE I MBRETTIT NË DISA VENDE SLLAVE					THEPI, CEPI LEGJENDA E "KUNG FU-së" ... LEE (shqip.)				ANA RUSO SHKRIMTARI ... ZOLA		
EPOKA E RE	SHKRIMTARI SHQIPTAR NË FOTO	E ZURA ME DORË	SHKURTABIQ	SHKOVA NË KEMBË, LËVIZA (bised.)	SECILA NGA TRAJTAT E NDRYSHME QË MERR EMRI	ZANORE AI QË E KISHTË DOBËSI THEMBRËN	PËRFUNDIMET DIKTATORI ITALIAN MUSOLINI					BARI I KORRUR E I THARË
	NJË PLANET NË SISTEMIN DIELLOR						ILAÇ		ISMET RAMUSHI		QENDËR E DIÇKAJE QYTET I MADH DHE KLUB FUTBOLLI NË ITALI	
	QË LARGOHET SHPEJT NGA NDONJË RREZIK						EMPLOYEES NUNAVUT UNION KRYEQYTETI I KANADASË		KRYEQYTETI I FILIPINEVE TRAJNERI GJERMAN ... REHAGEL			
	SHËRIM, PËRMIRËSIM SHËNDETI						"SOMALIA" MËNYRË E SHQIPTIMIT ME HUNDË TË TINGUJVE (ling.)		KRYEQYTETI I ESTONISË (pashq.) NËNË (krah.)			
	OSE			FUTBOLLISTI LALA KRYEQYTETI I JORDANISË (pashq.)			KRYEMINISTRI I TURQISË REXHEP ... ERDOGAN THIKA QË MBAHEJ SI ARMË BREZI				TEDI ALVES GRUP I VOGËL BESIMTARËSH ME NJË DO- GMË TË VEÇ- ANTË (shq.)	
	KËNGËTARJA VALENTINA				I SULMON ELEKTRODA E POLIT POZITIV NË NJË BURIM RRYME					OKSIGJEN, SELEN KËSTI BANKAR		FUTBOLLISTI BUSHI
	BASHKËT.		KËNGËTARJA ANGLEZE BUNTON KRYENGRITJA		ENË DRURI PËR TË MBAJTUR BULMET BIMË ME TRUNG TË TRASHË			MODERAT- ORJA HOTI PËMË E VENDEVE TË NGROHTA				
	SHTET NË EVROPË					KAFSHË MËMË (shq.) KËNGËTARJA E FAMSHME MEKSIKANE RUBIO			KLUB FUTBOLLI NË SUEDI KËNGËTARJA SKOCEZE ... LENOKS		SHKRONJA XVI NITROGJEN	
	"TETOVA"		SHPEND UJI SHTEGTAR PARIA E SHOQËRISË (sh.shq.)		TRUP QIELLOR QË RROTULLOH- HET RRETH DIELLIT I VRAZHDE					TANTAL, BOR LLOJ PIJE ALKOOLIKE (shq.)		
	HEROINË SHQIPTARE ... PALIKUQI			NJËRA NGA "EMIRATET E BASHKUARA ARABE" LLOJ GJELLE				METODË STUDIMI ELIZABETH TAYLOR				
EPOKA E RE	KËNGËTARJA LILA HOV, VRULL					ELEMENT KIMIK (shq.) BASHKËT.				ZANORE ISH FUTBOLLISTI ANGLEZ SHEARER (org.)	OLIVER NEUVILLE UNIVERSITETI I PRISHTINËS	
	KËNGËTARJA ZAHARIA				PORTOFOLI SHKRONJA TË NJËJTA					QË DO ZGJIDHJE SHUMË TË SHPEJTË PËRËMËR VETOR		KANDËRR E VOGËL DHE E ZEZË QË BREN DRURIN
	NJËSI PËR MATJEN E LËNGJEVE BANJË ALLATURKA (shq.)					HISTORIANI ROMAK LUKRECI		LLOJ PIJE E VENDEVE ORIENTALE DRITËRO AGOLLI			BASHKËT. ROMA, NAPOLI	
						ALEN NURI BASHKËT.		LIBËR PËR MBAJTJEN E SHËNIMEVE DITORE BASHKËT.			ROBERT REDFORD ZANORE	
	VEPËR E JOSIP RELËS				DHOMA KU MBAHET MËSIMI NË SHKOLLË				JONI ME NGARKESË NEGATIVE			



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. – Prishtinë, Ad: " Luan Haradinaj", p.n.
Tel: 038/249-424, Fax: ++381(0)38/ 249-430.
e-mail: contact@pallatirinise.com

Në bazë të vendimit të Bordit të Drejtorëve, Ndërmarrja Publike Lokale PALLATI I RINISË SH.A., shpallë:

FTESË PËR OFERTË PËR DHËNIEN ME QIRA TË HAPËSIRAVE AFARISTE

Ftoheni që të ofertoni për marrje në shfrytëzim me qira të lokaleve afariste, zyre dhe depot të cilat janë pronë e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. Pronat e evidentuara me poshtë u jepen me qira personave juridik.

Hapësirat afariste të cilat jepen me qira:

Nr.	Adresa	Sipërfaqja m ² (pa TVSH)	Çmimi fillestar për m ² (pa TVSH)	Nr.	Adresa	Sipërfaqja m ² (pa TVSH)	Çmimi fillestar për m ² (pa TVSH)
1.	Lokali nr.50	22 m ²	18.17€	8.	Depo nr.02	54 m ²	6.17€
2.	Lokali nr.52	42 m ²	16.80€	9.	Depo nr.04	70 m ²	6.17€
3.	Lokali nr.58	96 m ²	14.78€	10.	Depo nr.05	60 m ²	6.17€
4.	Lokali nr.65	20 m ²	18.80 €	11.	Depo nr.06	70 m ²	6.17€
5.	Lokali nr.67	12 m ²	21.00€	12.	Depo nr.07	70 m ²	6.17€
6.	Lokali nr.68	23 m ²	18.17€	13.	Depo nr.08	60 m ²	6.17€
7.	Lokali nr.71	6 m ²	21.00€	14.	Zyre 116/3	60 m ²	5.00€

Sqarim: Lokali nr. 58 i përbëhet në veti hapësirat edhe e dy lokaleve tjera, nr. 59 dhe 61.

Kushtet e Përgjithshme

1. Periudha e qiradhënies është për 1 (një) vit, me mundësi vazhdimi.
2. Qiramarrësi me anë të nënshkrimit të kontratës me qiradhënës, është i obliguar që të bëjë parapagimin e një shumë monetare në vlerë të një qiraje mujore në logari të Qiradhënës.
3. Qiramarrësi është i obliguar që pas nënshkrimit të kontratës të bëjë sigurimin e mallit nga kompanitë e sigurimit.
4. Përveç çmimit fillestar, qiramarrësi do të paguaj plus shpenzimet tjera të parashikuara me kontratë (rrymë, pastrim, nxeheje, ujë, kanalizim).

Kriter për përzgjedhjen e ofertesit me të favorshëm është:

1. Çmimi me i lartë i ofertuar se sa çmimi fillestar.
2. Tarifa e aplikimit është 200.00 €, ku ofertuesit të zgjedhur, tarifa e aplikimit do ti kompensohet me faturën e parë të qirasë, ndërsa ofertuesit të zgjedhur i cili tërhiqet nga Kontrata për qira, nuk i kthehet tarifa e aplikimit prej 200.00 € dhe ofertuesit të pajzgjurur i kthehet tarifa e aplikimit prej 200.00 €, e cila do të paguhet në këtë Kont: 1708020600000056.

Ofertuesi duhet t'i dorëzojë këto dokumente:

1. Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe numrit fiskal (kopje)
2. Kopjen e një dokumenti identifikues të pronarit ose të përfaqësuesit të biznesit; (kopje)
3. Çmimin e ofertuar për m² i cili duhet të jetë pa TVSH (Ofertë)
4. Vërtetimin nga ATK-ja, që të dëshmohet se biznesi është aktiv;
5. Fletëpagesën për aplikim.

Ofertat nuk do të merren parasysh nëse:

1. Ofertuesi i cili ka pasur lokal me qira në Pallatin e Rinisë dhe nuk i është përmbajtur kontratës së qirasë ose ka obligime ndaj Ndërmarrjes;
2. Nëse oferta nuk i përmban të gjitha dokumentet e kërkuara;
3. Nëse Oferta arrin pas datës së skadimit të afatit të dorëzimit të ofertave të përcaktuar në shpallje.

Personat juridik të cilët duan t'i vizitojnë lokale, zyrat si dhe depot e lartcekura, mund t'a bëjnë, nga data: **08.01.2020**, deri me datën: **14.01.2020** nga ora 10⁰⁰ deri në ora 15⁰⁰.

Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur me datën: **15.01.2020** nga ora 10⁰⁰ deri në orën 12⁰⁰, në zyrën e arhivës së qiradhënës N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të specifikohet: emri i ofertuesit, nr i lokalit, zyrës ose depot dhe kontaktet, si: email-i zyrtar, dhe/apo nr. i telefonit.

Ofertat do të hapen nga ana e komisionit, me datë: **15.01.2020**, nga ora: **12:30**, në prezencën e ofertuesve, në zyrën e Drejtorisë së Pallatit të Rinisë në Prishtinë.

Kërkesa (aplikacioni) mund të kërkohej përmes email-it: arditah@pallatirinise.com, në formë fizike në zyrën nr. 17, apo të shkarkohet nga faqja zyrtare e "Pallatit të Rinisë": <http://www.pallatirinise.com/>.



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. – Prishtinë, Ad: " Luan Haradinaj", p.n.
Tel: 038/249-424, Fax: ++381(0)38/ 249-430.
e-mail: contact@pallatirinise.com

Na osnovu odluke Borda, Lokalno Javnog Proizvedaca PALLATI I RINISË-A.D, Objavluje:

POZIV ZA PONUDU ZA IZDAVANJE POD KIRIJOM POSLOVNOG PROSTORA

Pozivate se da ponudi te za uzimanje na koriscenje pod kirijom poslovnog prostora, kancelarije I magacine koje su vlasnistvo L.J.P. "PALLATI I RINISE "A.d. Dole navedeno vlasnistvo se izdaje pod kirijom pravnim licima.

Poslovni prostor:

Br.	Adresa	Povrsina	Osnovna cena po m ² (bez PDV)	Br.	Adresa	Povrsina	Osnovna cena po m ² (bez PDV)
1.	Lokal br.50	22 m ²	18.17€	8.	Depo br.02	54 m ²	6.17€
2.	Lokal br.52	42 m ²	16.80€	9.	Depo br.04	70 m ²	6.17€
3.	Lokal br.58	96 m ²	14.78€	10.	Depo br.05	60 m ²	6.17€
4.	Lokal br.65	20 m ²	18.80 €	11.	Depo br.06	70 m ²	6.17€
5.	Lokal br.67	12 m ²	21.00€	12.	Depo br.07	70 m ²	6.17€
6.	Lokal br.68	23 m ²	18.17€	13.	Depo br.08	60 m ²	6.17€
7.	Lokal br.71	6 m ²	21.00€	14.	Kanc. br. 116/3	60 m ²	5.00€

Objasnjenje: Lokacija br. 58, sastoji se od dve prostorije, br. 59 i br. 61.

Opsti uslovi

1. Rok ugovora je godinu dana sa mogucnoscu ponovnog proizdenja,
2. uzimaoc lokala je duzan da uplati jednu kiriju- ratu po potpisivanju ugovora
3. Uzimaoc lokala je duzan da osigurava svoje imovinu ,material,kod osiguravajuci drustva,
4. Uzimaoc lokala je duzan da pored osnovne cene lokala da uplati dodatne troskove kao sto je propisano u ugovorom kao sto: je {struja,cistocu,grejanje, vodovod I kanalizaciju}.zž

POVOLNI USLOVI ZA DOBIJANJE LOKALA

1. Najveca cena od onovne cene.
2. Naknada za prijavu trebala bi iznositi 200,00 €, gdje ce odabrani ponuditelj naknadu za nadoknadu nadoknaditi prvim računom za najam, dok je odabrani ponuditelj koja se odustaje od Ugovora o zakupu, naknada za prijavu u iznosu od 200,00 € neće se vratiti, a prijava od 200,00 € vraća se neuspješnom ponuditelju, što će se uplatiti na ovaj račun: 1708020600000056.

Ponudilac treba da predaje ova dokumenta:

1. Uverenje o registraciju bisnisa I fiskalni broj –Fotokopje
2. Dokumentat za identifikaciju lica -Fotokopje
3. Cena za ponudu po m²,koja treba da bude bez PDV.
4. Potvrda od UPK koje svedoci da je aktivan bisnis,
5. Uplatni list za aplikaciju.

Ponuda neće se uzimati u obzir u koliko:

1. Ponudilac koji imao ili ima lokal u ovo proizdece a nije izvrsio svoje obaveze propisane ugovorom,
2. U koliko ponuda ne poseduje kompletu dokumentaciju,
3. Ako se ne dostavi ponuda na odrdnenom roku propisano u uslovima obavestjenja.

Lice koja zeli da posecuje gore navedeni poslovni prostor, mogu da posecuje od datuma: **08.01.2020** do **14.01.2020**, Od: 10⁰⁰ do 15⁰⁰.

Ponuda treba da se preda u zatvorena u koverti datumom: **15.01.2020** od 10⁰⁰ do 12⁰⁰, u Arhivi Proizvedaca L.J.P "PALLATI I RINISE" A.d. Na spolnoj strani koverta treba da bude upisano: Ime i Prezime ponudioca br.lokala ili kancelarije ,email adresa ili br.telefona. Ponude bice otvorene od strane komisije datumom: **15.01.2020 od 12:30**, javno pred licima ponudioca,u kancelarija uprave proizdeca.

Zahtev (aplikacija) mozete pronaci na (email adresu): arditah@pallatirinise.com, ili licno mozete podici u kancelariji br.17, ili preuzeti sa zvaničnog sajta "Pallati i Rinise" : <http://www.pallatirinise.com/>.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Besart (Rasim) Mustafa, shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e SHM. "Qendra e Kompetencës" Skenderaj.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m² dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m², kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpijan kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpijana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralla Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare. Tel. 044-413-197.

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjeipuneshpeite

KALONI FESTA TË GËZUARA DHE EFIÇIENTE!

BËHUNI BASHKË

Mblidhuni tek kushdo që ka shtëpinë më të madhe dhe më të izoluar – qoftë në shtëpinë tuaj, apo tek familjarët/miqtë tuaj. Ngrohja e një hapësire të përbashkët, në vend të më shumë hapësirave, do të kursejë energji, por edhe do të ngrohë zemrat tuaja.



ENËT DHE RROBAT LANI PËRNJËHERË

Mbusheni makinën e larjes së enëve maksimalisht para se t'a ndizni atë. Njësoj veproni edhe me rrobalarësen, por këtë herë vendoseni në minimum temperaturën e ujit.



PËRQAFOHUNI

Shpërndani energji pozitive tek njëri-tjetri. Kjo do të ju ngrohë juve dhe atë që e përqafoi, pa pasur nevojë të përdorni burime tjera të ngrohjes.


GATUANI PËR NJËRI-TJETRIN

Përgatitni aq sa keni nevojë, por përgatitni çdo gjë në të njejtën kohë. Një furrë që punon me kapacitet maksimal shpenzon më pak energji se sa disa furra që shfrytëzohen pjesërisht por që punojnë gjatë tërë ditës.



DASHURINË DHE NGROHTËSINË MBAJENI BRENDA

Izoloni mirë dyert dhe dritaret. Në n dërkohë, deri sa të aplikoni për mbështetje nga programi SEEK, gjeni shirita izolues nëpër dyqane me produkte ndërtimore.



MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO JU URON FESTAT E FUNDVITIT!

Në vitin 2020, vizitoni faqen tonë millenniumkosovo.org/seek për të përftuar nga SEEK - Subvencionet për Energji Efikase, programi që mbështetë familjet në investime për eficiency të energjisë.